

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL

ARSIMI
DHE
FORMIMI PROFESIONAL

11

Tiranë, 2009

Redaktor shkencor dhe letrar:
Prof. dr. Pajtim BEJTJA

Përgatiti për botim:
Ismet NESIMI

PËRMBAJTJA

Ruzhdi REÇI Strategjia sektoriale për zhvillimin e rrjetit të shkollave të hoteleri- turizmit.....	5
Prof. dr. Pajtim BEJTJA Procesi i Kopenhagenit për forcimin e bashkëpunimit evropian në arsimin dhe formimin profesional.....	19
Lindita DHIMA Përcaktimi i “kriterëve të realizimi” për vlerësimin e nxënësve në AFP.....	33
Albina BUCI Përdorimi i pyetjeve gojore për vlerësimin e nxënësve në AFP.....	39
Mirela ANDONI Parimi i “vlefshmërisë” në vlerësimin e nxënësve në AFP.....	51
Mirela ANDONI Parimi i “autenticitetit” në vlerësimin e nxënësve në AFP.....	59
Alqi MUSTAFAI Parimi i “prakticitetit” në vlerësimin e nxënësve në AFP.....	65
Lindita DHIMA Vlerësimi i produktit të punës së nxënësve në AFP.....	67
Mirela ANDONI Vlerësimi i procesit të punës së nxënësve në AFP.....	75
Mirela ANDONI Njësimi i rezultateve të vlerësimit të nxënësve.....	81
Ruzhdi REÇI Projekte në arsimin profesional e teknik.....	85

Strategjia sektoriale për zhvillimin e rrjetit të shkollave të hoteleri-turizmit

Ruzhdi REÇI
Ministria e Arsimit
dhe e Shkencës

1. Përshkrim i shkurtër i politikës shqiptare në lidhje me arsimin profesional e teknik

Në Programin e saj për periudhën 2005–2009, qeveria shqiptare i referohet zhvillimit të burimeve njerëzore, duke përfshirë edhe AFP-në, si më poshtë:

- Synimi më madhor i shoqërisë shqiptare, investimi për zhvillimin njerëzor, do të përbëjë prioritetin kryesor të projektit të ndryshimit.
- Rritja e pjesëmarrjes në një arsim cilësor e masiv të shqiptarëve, do të jetë politika e parë në këtë drejtim.
- **Vizioni i qeverisë për arsimin bazohet në modelin e arsimit të vazhdueshëm, duke filluar që në moshën parashkollore dhe duke vazhduar gjithë jetën.**
- Sistemi arsimor do të bazohet në autonominë shkollore.
- Qeveria angazhohet për një reformë tërësore në arsim, të mbështetur nga burime të konsiderueshme publike, nga zgjerimi i mbështetjes së partnerëve ndërkombëtarë si dhe nga përfshirja e sektorit privat në këtë fushë.
- **Reformat arsimore do të hartohen dhe zbatohen në konsultim e bashkëpunim të gjerë me grupet e interesit.**
- Në arsimin parauniversitar do t'u jepet përparësi shkollave të mesme profesionale, në përputhje me prirjet rajonale të zhvillimit ekonomik e të tregut të punës.

- Në zonat rurale do të hapet një numër i madh shkollash profesionale, kryesisht të profilit të agrobiznesit.
- Në shkollat profesionale do të synohet të tërhiqet më shumë se 40% e nxënësve të shkollave të mesme.
- Shpenzimet publike për arsimin, përfshirë atë universitar, do të përbëjnë zërin e parë në buxhetin e shtetit, duke arritur në një nivel prej 5% të PBB-së (në 2009).
- **Krahas fondeve publike, në përmbushjen e objektivave të arsimit parauniversitar do të kontribuojnë donatorët dhe iniciativa private.**
- Në fund të periudhës 4-vjeçare të arrihet niveli prej 100% i kryerjes së arsimit 9 -vjeçar dhe niveli 88% i kryerjes së arsimit të mesëm të përgjithshëm ose profesional.
- Tërheqja e fëmijëve në sistemin e edukimit parashkollor, synohet të arrijë në rreth 60%.
- **Rritja e ritmeve të zhvillimit ekonomik njëkohësisht synon edhe që ky zhvillim të krijojë vende të reja pune të mjaftueshme për të ulur papunësinë në nivelin e vendeve evropiane.**
- **Do të përdoren me efikasitet programe dhe instrumente të provuara si të suksesshme për të mundësuar rregullimin e defekteve të tregut të punës, si p.sh. instrumentet e informacionit, të ndërmjetësimit, të trajnimeve profesionale, të lehtësirave fiskale etj.**
- **Programet e nxitjes së punësimit do të zbatohen në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile dhe sektorin privat. Ato do t'u përshtaten realiteteve, nevojave dhe tendencave urbane, rurale e rajonale.**

2. Vështrim i përgjithshëm i arsimit të hoteleri- turizmit në Shqipëri

Ndryshimet politike, ekonomike dhe sociale, që kanë ndodhur në vendin tonë në pesëmbëdhjetëvjeçarin e fundit, si rezultat i kalimit nga ekonomia e centralizuar në ekonominë e lirë të tregut, kanë ndikuar

dukshëm edhe në fushën e hoteleri-turizmit. Transformimet, që sollën lindjen e ekonomisë së tregut, kanë shtruar para shoqërisë nevojën për nivele të reja kualifikimi në drejtim të shërbimeve të reja.

Orientimi nga tregu i punës si dhe nga praktika, së bashku me kërkesën për fleksibilitet, janë tani pika të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të hoteleri-turizmit, për t'i dhënë atij një fytyrë të re dhe për të arsimuar dhe pajisur brezat e rinj me shkathtësitë e shprehite e nevojshme, që kërkohen sot nga tregu i punës.

Në strukturën aktuale të AFP-së (1995- 2008) shkollat e hoteleri-turizmit bëjnë pjesë në shkollat profesionale 3+2 vjeçare, kurse shkollat e turizmit bëjnë pjesë në shkollat teknike 5-vjeçare.

Shkollat e hoteleri-turizmit (të krijuara për herë të parë në vitin 1996) ofrojnë arsimimin profesional nxënësve mbas përfundimit të arsimit të detyruar. Ky arsimim ka karakter të theksuar praktik dhe këto shkolla në nivelin e parë, 3-vjeçar, përgatisin kuzhinierë, kamerierë dhe recepsionistë me kualifikim bazë, kurse në nivelin e dytë, 2- vjeçar, përgatisin specialistë me kualifikim më të lartë, të pasuruar edhe me elemente të menazhimit dhe të ekonomisë.

Në këto shkolla, raporti në përqindje i lëndëve të kulturës së përgjithshme me lëndët e kulturës profesionale dhe me praktikat profesionale e prodhuese që zhvillohen gjatë tri viteve të shkollimit, është 34% : 33% : 33%.

Ky raport është zgjedhur i tillë, me synimin që këto shkolla ta përgatisin nxënësin jo vetëm si punëtor të kualifikuar me kompetenca të mira profesionale, por edhe si qytetar të denjë të shoqërisë. Në këto shkolla mund të regjistrohen të gjithë nxënësit që kanë përfunduar arsimin e detyruar dhe janë në gjendje të mirë shëndetësore.

Në fund të periudhës trevjeçare të shkollimit, nxënësi, që i merr provimet përfundimtare, fiton: “Dëftesën e Përfundimit të Shkollës Profesionale” dhe “Certifikatën e Aftësisit Profesional në profesionin përkatës” dhe i drejtohet tregut të punës me njohuritë bazë dhe kompetencat profesionale si: kamerier, kuzhinier dhe recepsionist.

Në përfundim të nivelit të dytë, 2-vjeçar, të shkollimit, nxënësi jep Provimet e Maturës Shtetërore, të cilat i lejojnë atij të konkurrojë për të vazhduar studimet e larta. Ato, gjithashtu, i japin mundësi atij të

konkurrojnë për një vend në tregun e punës, në nivelin e menazherit të hoteleve dhe të restoranteve.

Shkollat teknike të turizmit (të krijuara për herë të parë në vitin 1994), ofrojnë arsimim teknik të nxënësve që kanë përfunduar arsimin e detyruar. Këto shkolla u japin nxënësve një arsimim të gjerë profesional e teknik si dhe njohuritë e shprehite e domosdoshme për një veprimtari të kualifikuar profesionale në rolin e agentit turistik.

Në këto shkolla raporti në përqindje i lëndëve të kulturës së përgjithshme, me lëndët e kulturës profesionale dhe me praktikat profesionale është rreth: 50 % : 28 % : 22 %.

Me marrjen e provimeve të Maturës Shtetërore, nxënësi fiton “Dëftesën e Pjekurisë” të shkollës teknike në specialitetin përkatës dhe “Certifikatën e Aftësisimit Tekniko Profesional “. Këto dy dokumente nxënësit i hapin rrugën për të konkurruar në tregun e punës të fushës përkatëse, si dhe i japin mundësi për të konkurruar dhe vazhduar studimet e larta.

3. Shtirja gjeografike e shkollave profesionale të hotelieri-turizmit dhe e shkollave teknike të turizmit

Shkollat profesionale të fushës së hotelieri - turizmit dhe shkollat teknike të turizmit janë shpërndarë në qytetet më kryesore (Tiranë, Durrës, Shkodër, Lezhë, Vlorë, Elbasan, Korçë, Sarandë, Pogradec, Berat dhe në komunën e Golemit në Kavajë). Në to studiojnë rreth 20% e nxënësve të arsimit profesionale e teknik.

Një pjesë e këtyre shkollave ka konvikte me kapacitete 100-150 vende, që u bën të mundur atyre ta shtrijnë ndikimin e vet në rang prefekturë ose në rang kombëtar. Në këto konvikte janë akomoduar rreth 12% e nxënësve të këtyre shkollave.

Vitet e fundit funksionojnë edhe shkollat private profesionale të hotelieri-turizmit, në të cilat studiojnë rreth 4% e nxënësve të shkollave të arsimit profesional publik.

Lista dhe vendndodhja e shkollave publike profesionale e teknike të hotelieri-turizmit

Nr	Shkolla/ Qyteti	Kualifikimet	Kohë zgjatja	Numri i nx.
1	Shkolla teknike e hotelieri- turizmit TIRANË	<u>Hotelieri-Turizëm</u> Teknologji ushqimore	3+2vjeçare “	590 nxënës 480 “
2	Shkolla profesionale “Hysen Çela“ DURRËS	<u>Hotelieri-Turizëm</u> Teknologji ushqimore	3+2vjeçare	458 nxënës 354 “
3	Shkolla teknike “Antoni Athanas” SARANDË	<u>Hotelieri-Turizëm</u>	3+2 vjeçare	130 nxënës
4	Shkolla teknike tregtare Vlorë	<u>Hotelieri-Turizëm</u> Turizëm	3+2 vjeçare 5 vjeçare	55 nxënës 76 nxënës
5	Shkolla teknike “Isuf Gjata“ KORÇË	<u>Hotelieri-Turizëm</u>	3+2vjeçare	65 nxënës 364 gjithsej
6	Shkolla profesionale “Enver Qiraxhi” POGRADEC	<u>Hotelieri -Turizëm</u>	3+2 vjeçare	54 nxënës 244 gjithsej
7	Shkolla profesionale “Sali Çeka” ELBASAN	<u>Hotelieri –Turizëm</u> Teknologji ushqimore	3 vjeçare “	114 nxënës 812 gjithsej
8	Shkolla Kamëz - Tiranë Rreth	<u>Hotelieri-Turizëm</u>	3+2 vjeçare	106 nxënës 754 gjithsej
9	Shkolla profesionale “Stiliano Bandilli” BERAT	<u>Hotelieri-Turizëm</u>	3+2 vjeçare	53 nxënës 686 gjithsej
10	Shkolla teknike ekonomike SHKODËR	Turizëm	5 vjeçare	115 nxënës 520 gjithsej
11	Shkolla teknike Golem KAVAJË	Turizëm	5 vjeçare	276 nxënës 535 gjithsej
12	Shkolla teknike “Kolin Gjoka” LEZHË	Turizëm	5 vjeçare	150 nxënës 402 gjithsej
13	Shkolla teknike Ekonomike TIRANE	Turizëm	5 vjeçare	100 nxënës 958 gjithsej

Lista e shkollave jopublike profesionale të hoteleri-turizmit

Nr	Shkolla	Dega	Kohëzgjatja	Qyteti
1	Profesionale "Hot -Turs"	Hoteleri-turizëm	3+2 vjeçare	Tiranë
2	Profesionale "V. Kajtazi"	Hoteleri-turizëm	3+2 vjeçare	Tiranë
3	Profesionale "V. Kajtazi"	Hoteleri-turizëm	3+2 vjeçare	Durrës
4	Profesionale " Drini Çake"	Hoteleri-turizëm	3+2 vjeçare	Pogradec

4. Numri i nxënësve në shkollat publike të hoteleri-turizmit në vite

Numri i nxënësve në shkollat publike të turizmit në vitin shkollor 2007-2008:

1. Shkolla e agroturizmit Golem Kavajë 276 nxënës
2. Shkolla teknologjike Shkodër 115 “
3. Shkolla “ Kolin Gjoka” Lezhë 150 “
4. Shkolla teknike ekonomike Tiranë 100 “
5. Shkolla teknike tregtare Vlorë 76 “

Gjithsej	710 nxënës në turizëm
	1634 “ “ hoteleri-turizëm

Në degët turizëm dhe hoteleri-turizëm këtë vit shkollor studiojnë gjithsej 2344 nxënës.

5. Donatorët dypalësh në shkollat profesionale të fushës së hoteleri - turizmit

Donator i vetëm potencial në fushën e hoteleri-turizmit është Austria, nëpërmjet Agjencisë së bashkëpunimit teknik ADA dhe Kulturkontakt e K- education – Austria, që kanë punuar dhe vazhdojnë të punojnë në bashkëpunim të ongushtë me Drejtorinë e Kurikulave të

Shkollat e H-T	1996-1997	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007-2008
TIRANE	30	60	90	130	200	240	280	340	420	500	530	590
DURRES	30	70	100	170	239	313	371	358	384	464	456	458
SARANDE				27	50	70	70	90	100	100	114	130
ELBASAN							25	54	59	85	85	114
VLORE							20	48	38	30		55
POGRDEC									26	16	21	63
KORCE												65
KAMEZ												106
BERAT												53
Gjithsej	60	170	270	397	669	853	1004	1130	1242	1514	1522	1634

- projektin rajonal të paktit të Stabilitetit: “ECO- NET”;
- projektin “AGRI-AP”.

Në këto projekte u përfshinë shkollat profesionale dhe teknike “Ekonomike” dhe “Hoteleri-turizëm” në Tiranë, “Teknologjike” në Durrës, “Tregtare” në Vlorë, “Teknologjike” në Shkodër dhe “Antoni Athanas” në Sarandë. Këto projekte synonin përmirësimin e përgatitjes së nxënësve si punëtorë të kualifikuar dhe si specialistë të mesëm në kualifikimet: hoteleri, turizëm dhe ekonomik.

Duhet thënë që në fillim se këto projekte janë pritur shumë mirë nga shoqëria civile, në mënyrë të veçantë nga shkollat profesionale, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore, ku këto projekte u zhvilluan dhe janë në vazhdim. Ato janë parë gjithmonë si një shans dhe ndihmë në kohën e duhur për të përmirësuar punën e tyre dhe për të rritur imazhin e shkollës së tyre, para komunitetit të prindërve, nxënësve dhe biznesit.

Drejtuesit dhe mësuesit specialistë, si përfituesit e parë të këtyre projekteve, kanë pasur një bashkëpunim shumë të mirë me zyrën austriake të projektit K-education në Tiranë, duke arritur që, me një punë serioze, të marrin atë që është synuar të arrihej nga këto projekte.

Në projektet austriake që synuan përgatitjen e shkollave model në fushat e hoteleri-turizmit dhe të ekonomisë, shkollat tona siguruan ndihmën e duhur në drejtim të:

- mbështetjes me specialistë dhe materiale të nevojshme për grupin e specialistëve tanë që hartuan kurikulat për kualifikimet e mësipërme.
- trajnimit të mësuesve specialistë dhe të drejtuesve të shkollave të “hotelieri-turizmit” të Tiranës, Durrësit, Shkodrës e të Sarandës brenda dhe jashtë shtetit, me specialistët më të mirë të shkollave homologe austriake.
- pajisjes me infrastrukturën e nevojshme në pajisje dhe makineri për kabinetet dhe repartet e praktikave profesionale të shkollave të hotelieri-turizmit të Tiranës, Durrësit, Sarandës dhe Vlorës.
- futjes në kurikulën e shkollës të elementeve të menazhimit, të prodhimit të produkteve ushqimore dhe të shitjes së tyre.
- ngritjes dhe pajisjes me infrastrukturën e nevojshme të Qendrës shqiptare të firmave ushtrimore (ALCT) dhe ngritjes së firmave të reja ushtrimore në shkollat e hotelieri-turizmit dhe ekonomike.
- trajnimit të mësuesve specialistë për përdorimin e pajisjeve dhe të makinerive për mbështetjen në zbatimin e kurikulës së re.
- përgatitjes së materialeve mësimore për mësuesit dhe nxënësit e shkollave në projekt dhe të shkollave të tjera homologe në vend në lëndët e më poshtme:

Kontabilitet, firmë ushtrimore, agjenci udhëtimi, ekonomi ndërmarrjeje, komunikim, recepsion, restorant, turizëm e marketing dhe

gjeografi turistike. Me këto materiale mësimore në formë dispensash, janë pajisur jo vetëm shkollat që ishin pjesëtare në projekt, por dhe shkollat e tjera që kanë degë hotelieri-turizmi në qytetet: Shkodër, Lezhë, Elbasan, Pogradec, Korçë dhe Berat.

Kurikula tradicionale e shkollës së hotelieri-turizmit të Tiranës është përmirësuar ndjeshëm. Kjo ka bërë, nga ana tjetër, që të rriten kërkesat nga ana e nxënësve për të vazhduar studimet në këtë shkollë dhe shkolla t’i seleksionojë kërkesat e tyre me zhvillimin e konkursit të pranimit. Duke rezultuar e suksesshme, kjo kurikul po përdoret në të gjitha shkollat që kanë degë hotelieri-turizmi.

Faza e dytë e projektit rajonal “TOUR-REG”, mbështeti shkollat profesionale të hotelieri-turizmit 3+2 vjeçare të Tiranës, Durrësit, Vlorës dhe të Sarandës.

Projekte të përbashkëta në fushën e hotelieri-turizmit, të zhvilluara në shkollat e mësipërme, janë mbështetur nga MASH-i me burime njerëzore e financiare për rikonstrukcionin ndërtimor të shkollave, konvikteve e të bazave prodhuese.

Nga bashkëpunimi i dyanshëm me këto projekte është arritur që:

- të përgatiten shkolla profesionale model, duke krijuar mundësinë e zgjerimit të rrjetit të këtyre shkollave, sapo të krijohen mundësitë financiare të buxhetit të shtetit.
- kurikula e re e përgatitur për këto shkolla është një bazë e mirë për hartimin në vitin shkollor 2009-2010 të kurikulës me dy nivele në bazë.
- përgatitja e një rrjeti mësuesish specialistë multiplikatorë të shkollave profesionale të hotelieri-turizmit të Tiranës, Durrësit, Sarandës etj., të cilët do të kontribuojnë për hartimin e kurikulës në nivel shkollë.

Në datën 14.02.2008, në mjediset e shkollës profesionale “Hysen Çela” në Durrës u zhvillua ceremonia e përfundimit të projektit rajonal “Tour Reg”, të financuar nga Zyra e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim ADA, me një vlerë prej 240.000 euro.

Në këtë aktivitet morën pjesë: Ministri i Arsimit dhe i Shkencës, përfaqësues të Ambasadës Austriake në Shqipëri, Drejtori i Zyrës Austriake të Bashkëpunimit Teknik, Drejtori Ekzekutiv i KulturKontakt

–Austria, koordinatoresha e bashkëpunimit arsimor e Ministrisë së Arsimit të Austrisë në Tiranë, Prefekti, Kryetari i Bashkisë dhe Drejtori i DAR-it Durrës, drejtues, mësues e nxënës të shkollës “Hysen Çela” dhe të shkollave të tjera në projekt etj.

Në përshëndetjen e tij, ministri i Arsimit dhe i Shkencës Genc Pollo falënderoi të gjithë aktorët që bënë mundur realizimin cilësor të këtij projekti, duke bërë që biznesit të fushës së hoteleri- turizmit t’i ofrohen specialistë me kompetenca profesionale bashkëkohore. Zoti Pollo theksoi edhe një herë, rëndësinë e rritjes cilësore dhe sasiore të nxënësve në arsimin profesional dhe veçanërisht të atij të hoteleri-turizmit për zhvillimin ekonomik të vendit dhe veçanërisht të qytetit të Durrësit, si porti më i rëndësishëm i ardhjes së turistëve.

Z. Christopher Opancar, Drejtor i Zyrës Austriake të Bashkëpunimit Teknik në Tiranë, vlerësoi bashkëpunimin shumë të mirë austriako-shqiptar, sidomos në fushën e arsimit profesional me projektet “Tour Reg”, “Agrial” dhe “Eco Net”, duke lënë hapur rrugën për projekte të reja, sidomos në drejtim të konsolidimit të shkollave të reja të hoteleri-turizmit dhe të atyre ekonomike.


Z. Kurt Wagner, Drejtor i Kultur Kontakt-Austria, vlerësoi punën e bërë nga projekti nëpërmjet Zyrës K- education në Tiranë dhe shkollave të përfshira në projekt në arritjen e qëllimit final për përgatitjen sa më të mirë të nxënësve.

Pas përshëndetjeve u kalua në një vizitë në laboratorët dhe repartet e pajisura në kuadër të projektit. Aktiviteti përfundoi me një koktej të përgatitur dhe të shërbyer me profesionalizëm nga nxënësit e shkollës.

6. Ristrukturimi i shkollave të hoteleri -turizmit për vitet e ardhshme

Në vitin shkollor 2009-2010 arsimi i detyruar nga 8-vjeçar kalon në 9-vjeçar, gjë që do të sjellë ndryshime strukturore në Sistemin Arsimor në Shqipëri dhe do të reflektohet edhe në kohëzgjatjen dhe nivelet e arsimit profesional e teknik.

Struktura e propozuar e AFP-së për vitin shkollor 2009- 2010 në përbërje të Sistemit Arsimor në Shqipëri është si më poshtë:



Ristrukturimi i niveleve të AFP-së do të bëhet duke u bazuar në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve Profesionale (KSHKP) dhe duke marrë parasysh nivelet rekomanduese të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (KEK).

Shkollat profesionale do të kenë tri nivele:

- Niveli I (2vite), hyrës në punësim, ofron certifikatë të përgatitjes bazë profesionale;
- Niveli II (1 vit), i punëtorit të kualifikuar, ofron certifikatë të përgatitjes profesionale;
- Niveli teknik (1 vit) ofron diplomën e maturës profesionale.

Shkolla teknike do të zgjasë 4 vjet, do të përgatisë teknikë/menaxherë dhe ofron diplomën e maturës shtetërore.

Cikli post-sekondar me orientim profesional është për nxënësit që mbarojnë arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe kërkojnë të marrin një kualifikim profesional.

7. Strategjia e sektorit të arsimit profesional për fuqizimin e shkollave të hoteleri-turizmit

Ky ristrukturim i shkollave të hoteleri-turizmit do të kërkojë zhvillimin sasior dhe cilësor të objekteve, mjediseve, mjeteve mësimore, kurikulave dhe të burimeve njerëzore, në mbështetje të dyfishimit të numrit të nxënësve të shkollave të hoteleri-turizmit nëpërmjet:

- modernizimit të kutikulave, nëpërmjet hartimit të kurikulës me dy nivele.
- pajisjes me bazën e nevojshme *materiale/didaktike* për mësimin teorik e praktik, shumëfishimit dhe shpërndarjes së materialeve mësimore të përgatitura në kuadër të projektit dhe botimit të teksteve të reja të lëndëve profesionale deri në vitin 2010.
- ndërtimit të *shkollave të reja* në Tiranë, Durrës, Elbasan etj.
- rikonstruksionit, shtesave, lirimit të mjediseve të zëna, si dhe shfrytëzimit më të mirë të kapaciteteve ekzistuese dhe hapjes së degës hoteleri-turizëm në shkollat : “Teknologjike” në Shkodër, “Agroturizëm” në Golem dhe “Kolin Gjoka” në Lezhë.
- ndërtimit të konviktit të ri për shkollën e hoteleri-turizmit “A. Athanas” në Sarandë dhe të bazës prodhuese për këtë degë në shkollën “Tregtare “ në Vlorë.
- institucionalizimit të bashkëpunimit midis AP-së dhe biznesit lokal, për të shfrytëzuar me efektivitet infrastrukturën e këtyre aktorëve në funksion të përgatitjes profesionale të të rinjve dhe të rriturve.
- pranimit të nxënësve dhe krijimit të kushteve për realizimin e praktikave profesionale në biznes, rekrutimit si fuqi punëtore në biznese të nxënësve që përfundojnë këto shkolla.
- ngritjes së një sistemi informacioni të kërkesë/ofertës në AFP, nëpërmjet futjes së internetit në sistemin arsimor, informatizimit të qendrave të formimit profesional, të zyrave të punësimit dhe të drejtorive rajonale të arsimit.
- krijimit të mekanizmave për orientimin profesional dhe këshillimin e karrierës, me mbështetjen edhe të partnerëve socialë.

- fuqizimit të mekanizmave për trajnimin e vazhduar të mësuesve, instruktorëve dhe të drejtuesve të shkollave, duke aktivizuar multiplikatorët e përgatitur nga projekti (në drejtimin metodik, profesional dhe menazhues).
- ngritjes dhe fuqizimit të rrjetit të firmave ushtrimore të shkollave të hoteleri-turizmit (si një mënyrë e re e të mësuarit me punën në ekip, me kompetenca profesionale) dhe shtimit të pjesëmarrjes së tyre në panairët kombëtare dhe ndërkombëtare të firmave ushtrimore.

Procesi i Kopenhagenit për forcimin e bashkëpunimit evropian në arsimin dhe formimin profesional

Prof. dr. Pajtim BEJTJA

Deklarata e Kopenhagenit

Në 30 nëntor 2002, ministrat e arsimit përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional të 31 vendeve evropiane (anëtare dhe kandidate të BE-së e të tjera), Komisioni Evropian dhe përfaqësuesit e partnerëve socialë në nivel evropian, në një takim të zhvilluar në Kopenhagen (29-30 nëntor), adoptuan ***Deklaratën e Kopenhagenit*** për forcimin e bashkëpunimit në AFP-në evropian.

Deklarata parashtron një strategji për të përmirësuar rezultatet dhe cilësinë e AFP-së në Evropë dhe për ta bërë atë më tërheqës. Ajo jep një kontribut të rëndësishëm në drejtim të zgjerimit të BE-së dhe në realizimin e objektivit strategjik të Këshillit Evropian të Lisbonës (mars 2000), për ta shndërruar BE-në, duke filluar që nga viti 2010, në ekonominë më konkurruese dhe më dinamike të botës, të bazuar në njohuri, të aftë për përparim ekonomik të qëndrueshëm, me vende pune më të shumta e më të mira dhe me një kohezion social më të madh. Deklarata i referohet edhe Rezolutës 'Objektivat e ardhshëm konkretë të sistemeve të arsimit dhe të formimit' të nënshkruar nga Këshilli Evropian i Stokholmit (mars 2001), në të cilën identifikohen tre objektiva strategjike për sistemet e arsimit dhe të formimit: të rritet cilësia dhe efektiviteti i sistemeve të arsimit dhe të formimit në Bashkimin Evropian; të lehtësohet për të gjithë mundësia e hyrjes në sistemet e arsimit dhe të formimit; të

hapen sistemet e arsimit dhe të formimit ndaj botës. Ajo, më në fund, i përgjigjet kërkesës së Këshillit Evropian të Barcelonës (mars 2002) për të forcuar bashkëpunimin në fushën e AFP-së, paralelisht me bashkëpunimin e nisur në arsimin e lartë, në zbatim të deklaratës së Bolonjës (19 qershor 1999), me qëllim që sistemet evropiane të arsimit dhe të formimit të bëhen një referencë botërore cilësie që nga viti 2010.

Deklarata specifikon prioritetet (përparësitë) dhe parimet kryesore për forcimin e bashkëpunimit, të identifikuara në Rezolutën për nxitjen e një bashkëpunimi të fuqishëm evropian në arsim dhe formim, të miratuar nga Këshilli i Bashkimit Evropian (Arsimi, Rinia dhe Kultura) në 12 nëntor 2002, që e vë atë mbi baza legale.

Prioritetet kryesore të përcaktuara në Deklaratë për t'u ndjekur nëpërmjet një bashkëpunimi të fuqishëm në arsimin dhe formimin profesional janë:

Dimensioni evropian

- Të forcohet dimensionin evropian në AFP për të rritur bashkëpunimin, me qëllim që të lehtësohet dhe të mbështetet lëvizshmëria (mobiliteti) dhe zhvillimi i bashkëpunimit ndërinstitucional, i bashkëpunimeve dhe i nismave të tjera ndërmjet vendeve të ndryshme, të gjitha me qëllim që profili i hapësirës evropiane të arsimit dhe të formimit të krijohet në një kontekst ndërkombëtar, në mënyrë që Evropa të njihet si një referim botëror për nxënësit.

Transparenca, informacioni dhe orientimi

- Të rritet transparenca në AFP nëpërmjet zbatimit dhe racionalizimit të mjeteve dhe të rrjeteve të informacionit, duke përfshirë integrimin në një kuadër të vetëm të instrumenteve ekzistuese, siç janë CV-ja evropiane, shtojcat e certifikatës dhe të diplomës, Kuadri i përbashkët evropian i referimit për gjuhët dhe Evropass.
- Të forcohen politikat, sistemet dhe praktikatat që mbështesin informimin, orientimin dhe këshillimin në shtetet anëtare, në të gjitha nivelet e arsimit, të formimit dhe të punësimit, veçanërisht në lidhje me mundësinë për të nxënë, arsimimin

dhe formimin profesional, transferueshmërinë dhe njohjen e kompetencave e të kualifikimeve, me qëllim që të mbështetet lëvizshmëria profesionale dhe gjeografike e qytetarëve në Evropë.

Njohja e kompetencave dhe e kualifikimeve

- Të hetohet sa mund të nxitet transparenca, krahasueshmëria, transferueshmëria dhe njohja e kompetencave dhe/ose e kualifikimeve midis vendeve të ndryshme dhe në nivele të ndryshme, nëpërmjet përpunimit të niveleve të referencës, parimeve të përbashkëta për certifikim dhe masave të përbashkëta, duke përfshirë një sistem transferimi kreditesh për arsimin dhe formimin profesional.
- Të rritet mbështetja për përpunimin e kompetencave dhe të kualifikimeve në nivel sektorial, nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit dhe të bashkërendimit, veçanërisht përfshirjes së partnerëve socialë.
- Të hartohet një paketë parimesh të përbashkëta lidhur me verifikimin e vlefshmërisë (*validation*) së të nxënësve joformal dhe informal, me qëllim që të sigurohet një pajtueshmëri e gjerë midis qasjeve në vende të ndryshme dhe në nivele të ndryshme.

Garantimi i cilësisë

- Të nxitet bashkëpunimi për garantimin e cilësisë, me fokusim të veçantë në shkëmbimin e modeleve dhe të metodave, si dhe në kriteret dhe parimet e përbashkëta për cilësinë në arsimin dhe formimin profesional.
- T'u kushtohet vëmendje nevojave për të nxënë të mësuesve dhe të instruktorëve në të gjitha format e arsimit dhe të formimit profesional.

Bazuar në këto prioritete, synohet të rritet bashkëpunimi vullnetar në AFP, me qëllim që të nxitet besimi i ndërsjellë, transparenca dhe njohja e kompetencave dhe e kualifikimeve dhe, në lidhje me këtë, krijimi i një baze për rritjen e lëvizshmërisë (mobilitetit) dhe lehtësimin e mundësisë për të nxënë gjatë gjithë jetës për të gjithë.

Parimet e formuluar në Deklaratë për forcimin e bashkëpunimit në arsimin dhe formimin profesional janë:

- Bashkëpunimi të bazohet në synimet për vitin 2010, të shpallura nga Këshilli Evropian në përputhje me programin e hollësishëm të punës, me qëllim që të sigurohet koherenca me paketën e objektivave të miratuar nga Këshilli i Bashkimit Evropian (Arsimi, Rinia dhe Kultura).
- Masat të jenë vullnetare dhe parimisht të realizohen nëpërmjet një bashkëpunimi nga poshtë - lart (dmth. në përputhje me nevojat e aktorëve kryesorë).
- Nismat të përqendrohen në nevojat e qytetarëve dhe të organizatave përdoruese.
- Bashkëpunimi të jetë gjithëpërfshirës dhe të përfshijë Komisionin, vendet anëtare, vendet kandidatë, vendet e tjera pjesëmarrëse në takim dhe partnerët socialë.

Mbështetur në këto prioritete dhe parime, midis vendeve evropiane është zhvilluar dhe po zhvillohet një proces i bashkëpunimit në fushën e arsimit dhe të formimit profesional, që quhet procesi i Kopenhagenit.

Procesi i Kopenhagenit

Dimensionet e procesit të Kopenhagenit

Procesi i Kopenhagenit ka dimensione të ndryshme. Ai është:

Proces politik. Procesi luan një rol thelbësor në vënien në dukje të rëndësisë së AFP-së në vendimmarrjet politike. Ai lehtëson vendosjen e qëllimeve dhe të objektivave të përbashkët evropianë, diskutimin e modeleve dhe të nismave kombëtare dhe shkëmbimin e shembujve të mirë nga praktika në nivel evropian. Në nivel kombëtar procesi ndihmon në përqendrimin më të madh tek AFP-ja dhe frymëzon reformat kombëtare.

Proces për përpunimin e instrumenteve (mjeteve) të përbashkëta. Një rol tjetër qendror i procesit është përpunimi i instrumenteve dhe i parimeve të përbashkëta evropiane, që ndihmojnë në forcimin e transparencës dhe të cilësisë së kompetencave e të kualifikimeve dhe në lehtësimin e lëvizshmërisë së nxënësve dhe të punëtorëve. Procesi hap rrugën drejt një tregu pune evropian dhe një hapësire evropiane të AFP-së, plotësuese ndaj hapësirës evropiane të arsimit të lartë.

Proces që edukon të mësuarit nga njëri-tjetri. Ai i lejon vendet pjesëmarrëse t'i gjykojnë politikatat e tyre në dritën e përvojës së vendeve të tjera dhe të sigurojnë një kuadër për të punuar së bashku, për të mësuar nga njëri-tjetri dhe për të këmbyer idetë, përvojën dhe rezultatet.

Proces që vë në lëvizje aktorët kryesorë. Procesi rrit përfshirjen e aktorëve kryesorë dhe mundëson kontributin e tyre për realizimin e qëllimeve të përbashkëta.

Drejtimet e procesit të Kopenhagenit

Procesi i Kopenhagenit është zhvilluar dhe po zhvillohet në disa drejtime:

1. Hartimi i një kornize të vetme (unike) për transparencën e kualifikimeve dhe të kompetencave.
2. Garantimi i cilësisë.
3. Ndërtimi i një sistemi evropian transferimi kreditesh për AFP-në.
4. Dimensionin evropian.
5. Verifikimi i vlefshmërisë së të nxënësve joformal dhe informal.
6. Forcimi i politikave, i sistemeve dhe i praktikave në fushën e orientimit për të nxënësve gjatë gjithë jetës.
7. Rritja e mbështetjes për përpilimin e kualifikimeve dhe të kompetencave sektoriale.

Arritjet e deritanishme të procesit të Kopenhagenit

Për procesin e Kopenhagenit janë vendosur edhe më pas prioritete politike për arritjen e objektivave të Lisbonës në fushën e AFP-së, brenda

kontekstit të programit të punës *Arsimi dhe Formimi 2010*. Vendosja e tyre është bërë në takimet e përdyvjeshme të ministrave përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional të 32 vendeve evropiane, të Komisionit Evropian dhe të partnerëve socialë evropianë, përkatësisht në Mاستriht (14 dhjetor 2004), në Helsinki (5 dhjetor 2006) dhe në Bordo (25-26 nëntor 2008). Në komunikatat përkatëse paraqiten arritjet gjatë dy viteve të mëparshme dhe prioritetet për forcimin e bashkëpunimit evropian në fushën e AFP-së gjatë dy viteve të ardhshme.

Ka një konsensus të përgjithshëm që procesi i Kopenhagenit ka qenë i suksesshëm dhe që tani është kaluar në një fazë, në të cilën në fokus duhet të jenë konsolidimi i strategjisë dhe zbatimi i parimeve dhe i instrumenteve të përpunuara që në vitin 2002.

Komisioni Evropian ka ngritur grupe teknike pune dhe grupe ekspertësh për të hartuar referencat dhe parimet e përbashkëta evropiane në mbështetje të politikave të vendeve anëtare në fushën e cilësisë, të transparencës dhe të njohjes (identifikimit) së rezultateve, pavarësisht nëse ato janë arritur në kontekste formale, joformale ose informale.

Ndër rezultatet më të rëndësishme të arritura, të lidhura drejtpërdrejt me qytetarët dhe sipërmarrjet, janë këto të mëposhtmet:

- **Europass** – një kornizë e vetme (unike) për transparencën e kualifikimeve dhe të kompetencave, e paraqitur në një konferencë të posaçme nën Presidencën e Luksemburgut, më 31 janar – 1 shkurt 2005.

Tani për tani ‘Europass’ përmban **CV-në evropiane** (bën të mundur që qytetarët të paraqesin në mënyrë të qartë dhe të hollësishme informacionin për të gjitha kualifikimet dhe kompetencat e tyre), **Shtojcën (Suplementin) e diplomës** (jep informacion për arritjet arsimore të qytetarit që zotërohen në nivelin më të lartë arsimor prej tij), **Shtojcën (Suplementin) e certifikatës** (përshkruan kompetencat dhe kualifikimet që i përgjigjen një certifikate trajnimi profesional), **Mobilipass-in** (shënon të gjitha periudhat që qytetari ka studiuar jashtë vendit të tij) dhe **Dosjen evropiane** të gjuhës (paraqit shprehitë gjuhësore të qytetarit). Në të ardhmen asaj mund t’i shtohen edhe dokumente të reja.

- Rezoluta e Këshillit për **fuqizimin e politikave, sistemeve dhe praktikave në fushën e orientimit për të nxënëit gjatë gjithë jetës**, që çon në një qasje koherente ndaj kësaj çështjeje nëpër sektorët e arsimit dhe të formimit në nivel komunitar dhe kombëtar. Faktorë kyç për përmirësimin e politikave të orientimit profesional (për karrierë) në Evropë janë përcaktuar:
 1. Rritja e sinergjisë, nëpërmjet programeve të arsimit dhe të formimit, për krijimin e një rrjeti evropian aktorësh kryesorë (politikëbërësish, partnerësh socialë dhe shoqatash të tjera të lidhura me ta), që mund të *fuqizojnë politikat dhe sistemet e orientimit* në BE.
 2. Roli i qeverive dhe i partnerëve socialë, si edhe i shërbimeve të orientimit profesional, në reklamimin e *të nxënëit në AFP* dhe të mundësive për karrierë profesionale, me qëllim mbështetjen e rritjes së fuqisë punëtore dhe të nevojave të bizneseve.
 3. Roli i qeverive dhe i partnerëve socialë në mbështetje të *ejës përpara në profesion/karrierë* të fuqisë punëtore, nëpërmjet zgjerimit të rrugëve të të nxënëit dhe kualifikimeve për pjesëmarrësit në AFP dhe për të diplomuarit kohë më parë.
 4. Roli i qeverive dhe i partnerëve socialë në mbështetje të përmirësimit të ofrimit të orientimit profesional në vendin e punës, me qëllim që të krijohen te punonjësit *shprehi për menazhimin e karrierës së tyre*.
- Konkluzionet e Këshillit për **“identifikimin dhe verifikimin e vlefshmërisë së të nxënëit joformal dhe informal”**, që mbështetin një paketë të përbashkët parimesh evropiane për të ndihmuar në krijimin e sigurisë dhe të besimit ndaj këtij sektori që zhvillohet me shpejtësi. Hartimi i kësaj pakete mund të shihet si element i një strategjie që mbështet të nxënëit gjatë gjithë jetës, duke u lejuar individëve të kombinojnë rezultatet e të nxënëit nga mjedise të ndryshme jetësore dhe shoqërore, pavarësisht nga statusi formal ose jo i tyre. Metodologjitë dhe sistemet për identifikimin, vlerësimin dhe njohjen e të nxënëit joformal dhe informal mund të përdoren për qëllime të ndryshme. Në arsimin dhe formimin formal verifikimi i

vlefshmërisë përdoret gjithnjë e më shumë për t'i hapur më tepër sistemet ndaj grupeve të reja të nxënësve, duke i lejuar ata të kombinojnë rezultatet e të nxënësve formal dhe joformal. Në botën e punës verifikimi i vlefshmërisë luan një rol thelbësor në strategjitë për zhvillimin e burimeve njerëzore. Është e nevojshme që të ngrihen urat midis botës së arsimit formal dhe botës së punës.

Një paketë parimesh të përbashkëta duhet të japë rekomandime për rritjen e cilësisë së metodave dhe të sistemeve të verifikimit. Së dyti, ajo duhet t'u adresohet të drejtave individuale, duke siguruar që qytetarët të kenë mundësi verifikimi, për vlerësim sa më të plotë të kompetencave të tyre, me një mënyrë të përshtatshme. Një qasje e përbashkët për cilësinë dhe të drejtat individuale siguron një bazë krahasimi për mënyrat e verifikimit në vende të ndryshme, në nivele dhe kontekste të ndryshme.

- Konkluzionet e Këshillit për **Garantimin e cilësisë në arsimin dhe formimin profesional**, që mbështesin një Kornizë të përbashkët të Garantimit të Cilësisë për sistemet dhe ofruesit e AFP-së.

Drejtime kryesore për garantimin e cilësisë janë konsideruar:

1. Shqyrtimi i standardeve dhe i normave ekzistuese kombëtare dhe ndërkombëtare, zbatimi dhe anët e forta e të dobëta të tyre.
2. Identifikimi i një bërthame të përbashkët kriteresh për përmirësimin e cilësisë në nivel evropian.
3. Përpunimi i një pakete të kufizuar indikatorësh koherentë cilësie për AFP-në, në bazë të praktikave të mira.
4. Hartimi i një udhëzuesi evropian për vetëvlerësim.
5. Identifikimi i institucioneve të garantimit të cilësisë.
6. Identifikimi i nevojave për të nxënë të mësuesve dhe të instruktorëve të AFP-së.

- **Korniza Evropiane e Kualifikimeve¹ (KEK)**, e rekomanduar nga Parlamenti dhe Këshilli Evropian dhe e adoptuar prej tyre më 23 prill 2008.

¹ European Qualifications Framework (EQF)

KEK-u do të ndihmojë për të kuptuar, 'përkthyer' dhe krahasuar kualifikimet nga një vend në tjetrin dhe për t'i lidhur sistemet kombëtare të kualifikimeve në një kornizë evropiane reference të përbashkët. Meqenëse sistemet e arsimit dhe të formimit ndryshojnë nga vendi në vend, ajo është shumë e rëndësishme kur njerëzit kërkojnë të nxënë ose të punojnë në një vend tjetër. Kjo do t'i bëjë kualifikimet më "të lexueshme" nga institucionet e arsimit dhe të formimit, nga punëdhënësit, nga autoritetet identifikuese dhe vlerësuese etj.

KEK-u do të mbulojë të gjithë sektorët e arsimit të përgjithshëm dhe profesional dhe të gjitha nivelet e arsimit, duke përfshirë edhe arsimin e lartë. Ai do të ndihmojë, gjithashtu, për të krahasuar kualifikimet e sektorëve-organizatave ndërkombëtare.

KEK-u është strukturuar në rreth tetë nivele dhe për secilin prej tyre përshkruhet çfarë njerëzit pritet të dinë, të kuptojnë dhe të bëjnë. Përshkrimi i shprehive që nevojiten në tregun e punës sipas niveleve të KEK-ut, mund, gjithashtu, të lehtësojë përshtatjen e njerëzve ndaj punëve.

Fokusimi në 'rezultatet e të nxënësve' ndikon në të gjithë sektorët dhe nivelet e arsimit dhe të formimit. Ai i bën vendet e ndryshme që t'i rishikojnë kualifikimet e tyre, t'i rihartojnë kurikulat dhe të përpunojnë standarde të reja profesionale dhe arsimore. Shumë vende evropiane po hartojnë (ose ripunojnë) dhe po debatojnë kornizat kombëtare të kualifikimit.

KEK-u jep mundësi për të sqaruar rolin e AFP-së në lidhje me format e tjera të arsimit dhe të formimit dhe ndihmon për të parë vlerat e tij.

- **Sistemi Evropian i Krediteve për AFP-në² (KEAFP)**, i rekomanduar nga Parlamenti dhe Këshilli Evropian dhe i adoptuar nga Komisioni më 9 prill 2008.

Zbatimi i këtij instrumenti do të mbështesë dhe do të nxisë lëvizshmërinë dhe aksesin ndërmjet vendeve të ndryshme për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe pa kufizim në AFP, duke lehtësuar transferimin dhe akumulimin e rezultateve të të nxënësve të arritura nga individët. KEAFP pritet të adoptohet nga Parlamenti dhe

² European Credit System for VET (ECVET)

Këshilli Evropian në fillim të vitit 2009 dhe do të adoptohet nga vendet anëtare të BE-së vullnetarisht. Ai do të jetë i pajtueshëm me Sistemin Evropian të Krediteve³ (SETK), që përdoret në sektorin e arsimit të lartë.

- **Korniza Evropiane e Referencës për Garantimin e Cilësisë⁴ (KERGC)** për AFP-në, e rekomanduar nga Parlamenti dhe Këshilli Evropian dhe e adoptuar nga Komisioni më 9 prill 2008. Kjo kornizë do të ndihmojë vendet anëtare të BE-së për të nxitur dhe monitoruar përmirësimin e cilësisë në nivele të ndryshme të AFP-së. Ajo siguron një bazë të përbashkët për hartimin më pas të parimeve, kritereve të referencës dhe të indikatorëve të cilësisë. Zbatimi i këtij instrumenti është, gjithashtu, vullnetar. Ai pritet të adoptohet nga Parlamenti dhe Këshilli Evropian në fillim të vitit 2009.

Prioritetet e mëtejshme të procesit të Kopenhagenit

Në komunikatën e adoptuar në fund të takimit të Bordosë (26 nëntor 2008) janë parashtruar katër objektiva të procesit të Kopenhagenit për periudhën 2009-2010, të cilat janë:

- **Përdorimi i mjeteve dhe i skemave për nxitjen e bashkëpunimit në fushën e AFP-së** - me përqendrim të veçantë në: i) krijimin e Kornizave Kombëtare të Kualifikimeve në bazë të rezultateve të të mësuarit, ii) Sistemin Evropian të Krediteve për arsimin dhe formimin profesional dhe iii) Kornizën Evropiane të Referencës për Garantimin e Cilësisë.
- **Rritja e cilësisë së sistemeve të AFP-së dhe bërja tërheqëse e tyre** – duke e bërë tërheqës AFP-në për të gjitha grupet e synuara dhe duke nxitur ekselencën dhe cilësinë.
- **Përmirësimi i lidhjeve midis AFP-së dhe tregut të punës** – me anë të i) përpunimit të instrumenteve të planifikimit, të fokusuar në punët dhe në shprehjet, në pajtim me Rezolutën e

Këshillit mbi “Shprehi të reja për punë të reja”, ii) sigurimit të përfshirjes së partnerëve socialë, iii) përmirësimit të orientimit dhe këshillimit (gjatë gjithë jetës), për të lehtësuar kalimin nga trajnimi në punë, iv) nxitjes së trajnimit të të rriturve, veçanërisht në vendin e punës, me vëmendje të veçantë në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), v) kryerjes së verifikimit të vlefshmërisë dhe vlerësimit (identifikimit) të rezultateve të të nxëniet joformal dhe informal, vi) rritjes së lëvizshmërisë (mobilitetit) dhe vii) rritjes së rolit të arsimit të lartë në AFP.

- **Forcimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit** – me anë të i) rritjes së eficientës së veprimtarive të ndërsjella të të mësuarit, ii) forcimit të lidhjeve midis AFP-së, arsimit të përgjithshëm, arsimit të lartë dhe trajnimit të të rriturve dhe iii) konsolidimit të shkëmbimeve dhe bashkëpunimit me vendet e treta dhe me organizatat ndërkombëtare, si OECD, Këshilli i Evropës, ILO dhe UNESCO.

Pavarësisht nga tiparet dhe zhvillimet e përbashkëta, larmia e AFP-së brenda BE-së dhe mungesa e njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve dhe të kompetencave janë pengesa të mëdha për mobilitetin dhe zhvillimin e tregut evropian të punës. Korniza Evropiane e Kualifikimeve (KEK), Korniza e transparencës Europass për qytetarët, Sistemi Evropian për Transferimin dhe Akumulimin e Krediteve (SETK) për arsimin e lartë dhe Sistemi Evropian i Krediteve për AFP-në (KEAFP), së bashku me disa marrëveshje të tjera, të financuara nga programi Leonardo da Vinci, në kuadër të programit të BE-së për të nxënëit gjatë gjithë jetës, janë instrumente thelbësore për reduktimin e pengesave dhe rritjen e mobilitetit nëpër Evropë. Këto instrumente do të vihen në jetë nën përgjegjësinë e veçantë të vendeve të ndryshme dhe të partnerëve socialë.

Për të matur progresin dhe për të rritur efektivitetin e masave të mara, është e nevojshme që të bëhet rregullisht monitorimi, vlerësimi dhe fdbeku i tyre. Për të ballafaquar ofertën e arsimit dhe të formimit me kërkesat e tregut të punës, duhet të vendosen lidhje të ngushta midis instituteve të AFP-së dhe botës së punës, si dhe të bëhet identifikim i hershëm, në nivel evropian, i nevojave për shprehi të reja ose për ndryshim të tyre.

³European Credit Transfer and Accumulation System (ECTS);

⁴European Quality Assurance Reference Framework (EQARF)

Vendet anëtare të BE-së inkurajohen të përdorin Fondin Social Evropian dhe Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal për të mbështetur zhvillimin e AFP-së. Në mënyrë të ngjashme, edhe vendet candidate kanë mundësi të marrin fonde për reformimin e AFP-ve të tyre.

Programi Leonardo da Vinci është një instrument kyç për të mbështetur zhvillimin, testimin dhe zbatimin e aksioneve të reja për çuarjen përpara të reformave në AFP. Ai siguron mbështetjen për përhapjen e novacioneve dhe të praktikave të mira, që ndryshe do të mbeteshin brenda kufijve kombëtarë. Aksioni i mobilitetit ka një ndikim të qartë pozitiv jo vetëm në individët e përfshirë, po edhe në institucionet në të cilat ata janë përfshirë. Për të gjithë periudhën 2007-2013, programi Leonardo da Vinci ka një buxhet prej 1725 miliardë eurosh, që përfaqëson 25% të buxhetit të përgjithshëm të programit për të nxënëit gjatë gjithë jetës.

Së bashku me programet *Komenius* (për arsimin e përgjithshëm), *Erasmus* (për arsimin e lartë) dhe *Grundvig* (për arsimin e të rriturve), programi *Leonardo da Vinci* (për arsimin profesional) është një komponent integral i Programit për të nxënëit gjatë gjithë jetës, 2007-2013. Përveç tij, financimin e mobilitetit dhe të modernizimit në fushën e arsimit profesional e bëjnë edhe burime të tjera, kombëtare, dykombëshe ose shumëkombëshe.

* * *

Bashkëpunimi evropian në fushën e arsimit dhe të formimit profesional, me qëllim reformimin e suksesshëm të tij, është i nevojshëm dhe i dobishëm jo vetëm për vendet e BE-së, por edhe për vendet e tjera evropiane, veçanërisht për ato që aspirojnë të futen në BE. Në lidhje me këtë, ka pasur nisma për shtrirjen e procesit të Kopenhagenit edhe në vende të tjera evropiane, duke përfshirë edhe Shqipërinë, e cila ka hyrë në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian qysh me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocijimit (MSA) në qershor 2006. Njohja dhe adoptimi i parimeve të Kopenhagenit janë konsideruar të rëndësishme për Shqipërinë, që ajo të kryejë në AFP një reformë të ngjashme me ato të vendeve të BE-së. Procesi i Kopenhagenit, sikurse dhe strategjia e Lisbonës dhe procesi i Bolonjës, janë prezantuar në Shqipëri dhe kanë ushtruar presion pozitiv ndaj niveleve politike që përmirësimet pjesore të

bëra në sistemin e arsimit e të formimit si përgjigje ndaj nevojave të ngutshme, të kalojnë në zgjidhje të plota afatgjata. Shqipëria, e asistuar nga Fondacioni Evropian i Trajnimit (ETF), ka bërë dhe po bën hapa në drejtim të modernizimit të AFP-së. Në radhë të parë, janë bërë përpjekje për të kuptuar dhe integruar problemet e politikave të BE-së të dala nga procesi i Kopenhagenit dhe programi i punës 'AFP 2010' në debatet për reformën kombëtare dhe sektoriale. Për këtë qëllim, në vitin 2005 u krijua një Grup Kombëtar për të përhapur informacionin për procesin e Kopenhagenit, u hartua një Plan kombëtar veprimi në zbatim të procesit të Kopenhagenit dhe u caktua edhe një Koordinator kombëtar. BE-ja po vazhdon të mbështesë reformën e AFP-së në Shqipëri, duke ofruar asistencë teknike me financim të programit CARDS. Aktivitetet janë përqendruar në përgatitjen e një dokumenti për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), bazuar në Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK). KSHK-ja do të jetë një strukturë me 8 nivele, të cilat u përgjigjen niveleve të KEK-ut, ku do të përfshihen të gjitha kualifikimet e ofruara në Shqipëri. Brenda KSHK-së do të njihen tri lloje kualifikimesh: a) **kualifikime të përgjithshme**, të fituara nga nxënësit e shkollave të mesme të përgjithshme ose të rriturit në nivelet 1-4 të KSHK-së, të hartuara nga Instituti i Kurikulave dhe i Trajnimit dhe të rregulluara nga MASH-i; b) **kualifikime të larta**, të ofruara nga ose në bashkëpunim me universitetet, në nivelet 5-8 të kornizës, të rregulluara nga MASH-i, nëpërmjet Këshillit të Akreditimit; c) **kualifikime profesionale**, të ofruara nga institucionet profesionale e teknike, qendrat e formimit profesional ose në vendin e punës, të rregulluara nga Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe e Formimit Profesional.

KSHK-ja do të ngrihet nëpërmjet një ligji të ri për kualifikimet, i cili do të krijojë edhe strukturën institucionale që do ta zbatojë atë.

Literatura:

- *Decision No 2241/2004/EC of the European Parliament and of the Council of 15 December 2004 on single Community framework for the transparency of qualifications and competences (Europass), website.*
- *Declaration of the European Ministers of Vocational Education and Training, and the European Commission, convened in Copenhagen on 29 and 30 November 2002, on*

enhanced European cooperation in vocational education and training (“The Copenhagen Declaration”), website.

- *Drejt kornizës shqiptare të kualifikimeve*, CARDSVET, Tiranë, 2008.
- *Enhanced Cooperation in Vocational Education and Training*, Stocktaking report of the Copenhagen Coordination Group, October 2003, website.
- *Krijimi i një kornize kombëtare kualifikimesh në Shqipëri*, gusht 2006.
- *Maastricht Communiqué on the Future Priorities of Enhanced European Cooperation in Vocational Education and Training (VET)* (Review of the Copenhagen Declaration of 30 November 2002), 14 December 2004, website.
- *Propozimet për përmirësim në legjislacionin shqiptar mbi arsimin dhe formimin profesional*, gusht 2006.
- *The Bordeaux Communiqué on Enhanced European Cooperation in Vocational Education and Training*, November 2008, website.
- *The Helsinki Communiqué on Enhanced European Cooperation in Vocational Education and Training*, December 2006, website.
- *Zooming in on 2010*, Cedefop, Luxembourg, 2007.

Përcaktimi i “kriterëve të realizimit” për vlerësimin e nxënësve në AFP

Lindita DHIMA
Agjencia Kombëtare e Arsimit
dhe e Formimit Profesional

Kuptimi dhe rëndësia e kriterëve të realizimit

Gjatë punës suaj si instruktor ju përdorni ata që quhen përshkrues modulesh, të cilët përbëhen nga një seri komponentësh, të detyrueshëm ose jo. Njëri prej komponentëve kyç të detyrueshëm janë, pikërisht, ato që quhen **kritere realizimi** (KR). Si rezultat, ato vijjnë pas çdo **rezultati të mësuarit** (RM) dhe lidhen ngushtësisht me to, sepse:

- ndërsa RM është përshkrimi i saktë i asaj se çfarë duhet të jetë në gjendje të bëjë nxënësi/kursanti,
- kriteret e realizimit përcaktojnë se **sa mirë** nxënësi/kursanti duhet të përmbushë veprimtarinë e përshkruar të RM-ja përkatës. Me fjalë të tjera, KR-të përcaktojnë *nivelin* dhe *cilësinë e përmbushjes* që kërkohet nga nxënësi/kursanti.

Duhet thënë se, nëse kompetenca e përgjithshme është shprehur në fillim të modulit (te “Qëllimi”), RM-të e zërthejnë këtë kompetencë në hapa, ose elemente përbërëse. Dhe, akoma më tej, KR-të dhe parametrat përcaktojnë se sa mirë duhet t’i përmbushë nxënësi/kursanti këta hapa.

Një RM duhet të jetë i matshëm, i arritshëm, i kuptueshëm dhe duhet patjetër të përmbajë një folje aktive (F) dhe një objekt (O), plus kushtet (K) e nevojshme që përcaktojnë kufijtë e veprimtarisë.

Shembuj:

Krijo (F) të dhëna grafike (O), duke përdorur komandat e programit CAD (K).

Këshillo (F) klientët (O) për produktet dhe shërbimet që plotësojnë nevojat e konsumit (K).

Përgatit një sipërfaqe për suvatim të jashtëm. Gjej foljen, objektin dhe kushtin!

Por, ka raste, kur nuk është e nevojshme të përfshihet kushti, nëse ky del i qartë nga vetë folja dhe objekti.

Shembuj:

Vlerëso (F) një situatë emergjence (O).

Identifiko (F) pemët (O).

Për të formuluar siç duhet RM-të, ka edhe rregulla të tjera, si qartësia, lidhja logjike me kompetencën e përgjithshme dhe me titullin e modulit etj.

Në shumicën e rasteve, del e nevojshme që çdo RM të shoqërohet, përveç KR-së, edhe me **parametrat** brenda të cilëve ky rezultat të mësuarit duhet të demonstron nga nxënësi/kursanti.

Shembull:

Shembull 1 (i drejtë) – KR-të dhe parametrat formulohen në përshtatje me RM-të.

RM: Identifiko pemët.

KR: Nxënësi/kursanti duhet:

- të identifikojë me saktësi pemë të zakonshme, pa përdorimin e një atlas botanik;
- të identifikojë me saktësi pemë jo të zakonshme, duke përdorur një atlas botanik;
- të identifikojë me saktësi tipare të jashtme të pemës, për sa i takon llojit dhe klasifikimit.

Parametrat:

Pemë të zakonshme: gjethegjera të zakonshme, halore të zakonshme

Pemë jo të zakonshme: gjethegjera jo të zakonshme, halore jo të zakonshme

Të tre komponentët e modulit, pra RM, KR dhe parametrat kanë një rol shumë të rëndësishëm, pasi përcaktojnë **standardin** që nxënësi/kursanti duhet të arrijë, me qëllim që të përmbushë krejt modulën. Ata janë shumë të rëndësishëm, gjithashtu, për mësuesit dhe instruktorët përgjegjës për **vlerësimin** e nxënësve/kursantëve.

Rregullat për hartimin dhe formulimin e kriterëve të realizimit

Siç e thamë më sipër, për çdo RM duhet të ekzistojë një listë me KR dhe parametra, të cilët, së bashku, përcaktojnë se **sa mirë** nxënësi/kursanti duhet të jetë në gjendje ta kryejë atë (RM) dhe brenda cilëve parametra, duke shprehur, kështu, *nivelin*, *cilësinë* dhe *qëllimin* (mënyrën) e përmbushjes që i kërkohet atij. Kjo do të thotë që KR-të dhe parametrat, së bashku, duhet të përcaktojnë nivelin, cilësinë dhe qëllimin e përmbushjes së kërkuar për *të gjitha* aspektet e veprimtarisë së përshkruar të RM-ja përkatës (shembull 1 i mësipërm). Aty nuk duhet të ketë mungesa të ndonjë KR-je, sepse duhet të mbulohen të gjitha aspektet e përmbushjes (që përmban RM-ja përkatës) dhe nuk duhet të përfshihet ndonjë aspekt i përmbushjes, që nuk mbulohet nga RM-ja.

Shembuj:

Shembull 2 (i gabuar) – KR-të dhe parametrat nuk përcaktojnë nivelet e përmbushjes së kërkuar për të gjitha aspektet e RM-së.

RM: Siguro informacion dhe këshillo klientët/vizitorët.

KR: Nxënësi/kursanti duhet:

- të konfirmojë menjëherë dhe me saktësi nevojat e klientëve/vizitorëve;

- të ndërmarrë veprime të përshtatshme për plotësimin e nevojave të klientëve/vizitorëve;
- të përdorë në mënyrë efektive burimet e informacionit në lidhje me plotësimin e nevojave të klientëve/vizitorëve.

Parametrat:

Burimet e informacionit: burime informacioni në letër dhe on-line; burime telefonike informacioni.

[*Shënim:* Duhet shtuar edhe një KR tjetër: të prezantojë në mënyrë korrekte informacionin në lidhje me nevojat e klientëve/vizitorëve.]

Shembull 3 (i gabuar) – KR-të dhe parametrat përmbajnë një aspekt të ri të përmbushjes, që nuk përfshihet nga RM-ja.

RM: Përgatit në formë skematike strategji alternative për zgjidhjen e një problemi.

KR: Nxënësi/kursanti duhet:

- të bëjë në mënyrë të përmbledhur skicimin e strategjive alternative për zgjidhjen e problemit;
- të analizojë në mënyrë kritike strategjitë;
- të për zgjedhë strategjinë e duhur në raport me kufizimet që vijnë nga jashtë.

Parametrat:

Kufizimet e jashtme: koha, kostot, kufizimet në burime.

[*Shënim:* KR-ja dhe parametrat e nënvizuar përmbajnë një aspekt të ri të përmbushjes, pasi ato mbulojnë *përzgjedhjen* e një strategjie, kurse RM-ja përfshin *vetëm përgatitjen në mënyrë skematike* të disa strategjive alternative.]

Gjatë formulimit të KR-ve duhet të mbahet parasysh që ato duhet:

- **të jenë të matshme.** Ka një sërë faktorësh që e bëjnë një KR të pamatshëm, të tillë si paqartësia; dykuptimësia; shprehja e varfër; referenca ndaj proceseve mendore, si “të kuptuarit”, “të qenit i ndërgjegjshëm”, “të dish si”; mos vendosja e fjalëve që shprehin nivelin apo cilësinë, si: “korrekt” ose “e përshtatshme”; theksimi

i aspektit jo të duhur të përmbushjes (i produktit ose i rezultatit në vend të procesit dhe e kundërta);

- **të shprehin cilësinë e përmbushjes;**
- **të jenë thelbësore,** duke iu referuar një procesi ose një produkti (ose rezultati).

Le të shohim dy shembujt e mëposhtëm:

Shembull 1: KR-të i referohen një produkti ose rezultati (me shkronja italiane):

Siguron *lidhjet*.

Siguron *regjistrime* të plota, të sakta dhe të lexueshme.

Siguron *informacion* thelbësor.

Shembull 2: KR-të i referohen një procesi (me shkronja italiane):

Arkëton paratë në përputhje me politikat, rregullat, procedurat dhe afatet e organizatës.

Kryen veprime në përputhje me udhëzimet e prodhuesit.

Zbaton planin sipas afateve të vendosura nga ai vetë dhe sipas specifikimeve në plan.

“Lista e kontrollit” si një paketë kriteresh realizimi

Një ndër instrumentet e vlerësimit të arritjeve të nxënësve/kursantëve është ai që quhet “listë-kontrolli”. Ky instrument shërben për vlerësimin e procedurës dhe nuk është gjë tjetër, veçse një listë hapash për përmbushjen e kompetencës. Lista duhet:

- të përmbajë të gjithë hapat e nevojshëm për kryerjen e veprimtarisë;
- të përmbajë hapat e domosdoshëm për sigurinë gjatë punës;
- të përmbajë hapat në renditjen e duhur;
- të krijojë mundësinë e dhënies së përgjigjes me “PO” dhe “JO”;
- të përmbajë nivelin minimum të përmbushjes;
- të jetë me një numër të arsyeshëm hapash dhe jo më shumë se një faqe.

Shembull

N r	Emri, mbiemri i nxënësit	Përzgjedhja e pajisjeve dhe e veglave të nevojshme për hapje kanalesh	Përdorimi i veglave dhe i pajisjeve për hapje kanalesh	Kryerja e veprimeve për hapje kanalesh	Hapja e kanaleve me daltë dhe çekëç	Hapja e kanaleve me frezë elektrike	Hapja e kanaleve me gur fleksibël	Zbatimi i rregullave të mbrojtjes në punë	REZULTATI
1.	Arben Xhafa	PO	PO	PO	PO	JO	PO	PO	PO
2.							
...	...								
...	...								

Literatura:

- *Samples of Assessment Criteria*, website.
- *Assessment Criteria*, website.
- “*Overview of Learner assessment*”, skillcard, Swisscontact.

Përdorimi i pyetjeve gojore për vlerësimin e nxënësve në AFP

Albina BUCI
Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe e Formimit Profesional

“Të dish të bësh pyetje, do të thotë të dish të japësh mësim. Arti i bukur i mësimdhënies varet nga mjeshtria e përdorimit të pyetjeve, pasi ajo shërben si drejtim për ide të gjalla dhe të qarta, të nxit me shpejtësi imagjinatën dhe mendimin, gjë që të shtyn për veprim.”

Xhon Djuj (John Dewey)

Rëndësia dhe përdorimi i pyetjeve gojore për vlerësimin e nxënësve/kursantëve

Koncepti i vlerësimit në praktikën e shkollës sonë ka evoluar. Si pasojë e këtij ndryshimi, rezultatet e nxënësve maten e vlerësohen me praktika dhe instrumente të reja bashkëkohore. Vlerësimi i nxënësve është pjesë shumë e rëndësishme e procesit mësimor në të dyja aspektet e tij, të mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Objektivi i çdo vlerësimi është përcaktimi i shkallës në të cilën nxënësi realizon objektivat mësimorë të parashikuar dhe i ndikimeve që ka mësimdhënia dhe të ushtruarit (të praktikuarit) në rezultatet e nxënësve. **Vlerësimi në klasë është procesi i gjykimit të informacionit të grumbulluar për të marrë vendimet përkatëse për të bërë përmirësimet e duhura.** Ky proces i vetëdijshëm nga mësuesit dhe nxënësit ndodh para, gjatë dhe pas procesit mësimor.

Para procesit mësimor, vlerësimi kryhet kryesisht: (i) për të njohur karakteristikat e nxënësve; (ii) për të planifikuar mësimdhënien.

Gjatë procesit mësimor, mësimdhënësit kryejnë vlerësimin për të marrë vendime që lidhen: (i) me zbatimin e programit mësimor; (ii) me të nxënësit; (iii) me drejtimin e klasës.

Pas përfundimit të procesit mësimor vlerësimi synon të japë përfundime lidhur: (i) me arritjet e nxënësve; (ii) me përparimin e tyre dhe (iii) me vendimet për të përmirësuar mësimin në vitin e ardhshëm shkollor. Vlerësimi kalon nëpër disa etapa, si: kontrolli, matja dhe vlerësimi.

- **Kontrolli** ka të bëjë me përfundimin e të mësuarit dhe shprehet në mënyra të ndryshme. Ai realizohet në çdo hap mësimor, nga i cili grumbullohet informacion mbi ç'dinë-çfarë u arrit, çfarë nuk dinë-çfarë nuk u arrit.
- **Matja**, e cila kryhet nga mësuesi me qëllimin e vetëm që ajo që kontrollohet të matet, shprehet me forma të ndryshme: *me pikë, me përqindje, me shprehje, me shenja dalluese* etj. Matja është proces krahasimi, që do të thotë se ky proces realizohet duke u bazuar në një **standard të përcaktuar qartë**. Megjithatë kontrolli bëhet gjatë gjithë orës së mësimin, matja, e cila shpesh është e pandarë nga vlerësimi, bëhet në etapa të caktuara të tij dhe jo çdo kontroll shoqërohet me matje.
- **Vlerësimi** nënkupton vendosjen e **vlerës** për gjykimin sasior ose cilësor të bazuar në matjen.

Etapat e mësipërme të vlerësimit realizohen me metoda, teknika e instrumente të ndryshme. Një nga metodat më praktike të përdorshme është “të pyeturit gojor”, i cili bazohet në përdorimin e pyetjeve. E gjithë kategoria e pyetjeve klasifikohet në dy grupe të mëdha:

a. Pyetje objektive (të mbyllura) – që përfaqësojnë ato lloje pyetjesh për të cilat mund të jepet vetëm një përgjigje. Zakonisht përdoren për të kontrolluar dhe vlerësuar nga ana sasore e cilësore njohuritë, shprehitë e shkathtësitë në nivelet e ulëta të tyre. Këto pyetje provokojnë dhe nxitin aftësitë memorizuese (e futjes në kujtesë) dhe rikujtuese të nxënësve. Vlerësimi i përgjigjeve të marra nga nxënësit kundrejt këtyre pyetjeve nuk varet nga vlerësuesi. Disa shembuj të pyetjeve të mbyllura janë:

- *Çfarë mësimi kemi sot?*

- *A dini të saldoni?*
- *A i njihni pjesët kryesore të një peme frutore?*
- *Çështje sëmundja?*

b. Pyetjet subjektive (të hapura) – që përfaqësojnë ato lloje pyetjesh për të cilat mund të jepen disa variante përgjigjesh. Këto pyetje, zakonisht, përdoren për të kontrolluar e vlerësuar njohuritë dhe shprehitë në nivelet më të larta të tyre. Duke përdorur këto lloje pyetjesh, nxitin të nxënësi aftësi të larta të të menduarit, si ato analizuuese, sintetizuese dhe vlerësuese. Nxënësi të ndryshëm ndjekin mënyra të ndryshme për të dhënë përgjigjen, e cila mund të jetë e shkurtër ose e gjatë. Vlerësimi i këtyre përgjigjeve varet nga vlerësuesi. Disa shembuj të pyetjeve të hapura janë:

- *Çfarë dini ju rreth perimeve?*
- *Cila punë është më e lodhshme, ajo mendore apo ajo fizike?*
- *Pse duhet t'i njohim dhe t'i mbrojmë sytë te pemët frutore e te hardhia?*
- *Si e mendoni ju botën në shekullin e ardhshëm?*

Në rastet kur nxënësi jep përgjigje kundrejt pyetjeve të mbyllura objektive, ai nuk mban qëndrim personal ndaj saj, pasi përgjigjja e saktë është e vetme. Ndërkaq, në rastin e pyetjeve të hapura subjektive, ai është i lirë të zgjedhë mënyra të shprehuri apo ta zgjidhë në forma të ndryshme pyetjen, duke përdorur njohuritë, qëndrimet, gjykimet dhe ndjenjat e tij. Për të rritur efektivitetin e mësimin dhe cilësinë e të nxënësit, mësuesit bëjnë pyetje të ndryshme në lloje e nivele. Për të arritur këtë, mësimdhënësit duhet të familjarizohen me konceptin e taksonomisë së pyetjeve dhe me përdorimin e saj në funksion të mbarëvajtjes së procesit mësimor.

Taksonomia e pyetjeve

Taksonomia e pyetjeve është një sistem për klasifikimin e pyetjeve sipas nivelit të vështirësisë. Pikërisht kjo taksonomi i ndihmon mësuesit të kuptojnë se pyetjet nuk janë të ngjashme; disa pyetje kontrollojnë të kuptuarit në nivel të lartë, kurse të tjerat bëjnë të njëjtën gjë, por në nivele më të ulëta. Pyetjet e nivelit të ulët kërkojnë që nxënësit të mbajnë mend diçka që kanë mësuar. Pyetjet e nivelit të lartë kërkojnë që nxënësit të realizojnë shumë detyra apo veprimtari, duke përdorur gjithçka kanë mbajtur mend e kanë kuptuar më parë. Për të zhvilluar plotësisht aftësitë mendore të nxënësve, mësuesit përdorin pyetje të të dyja niveleve. Mësuesit

duhet të hartojnë pyetje të cilat përfshijnë një sërë shprehish të të menduarit, që nga ato më të ulëta deri tek ato më të larta, në varësi të objektivave mësimorë. Taksonomia e pyetjeve, sipas Blumit (Bloom), përfshin gjashtë nivele (pyetjet e njohjes, të të kuptuarit, të zbatimit, të analizës, të sintezës dhe të vlerësimit). Lloji më i thjeshtë dhe niveli më i ulët i pyetjes është **pyetja e njohjes**, me anë të së cilës i kërkohet nxënësit të rikujtojnë e të japë përgjigje nga njohuritë e memorizuara, pra të mbajtura mend, qofshin këto edhe të pa kuptuara si duhet. Lloji më kompleks dhe niveli më i lartë i pyetjes është **pyetja e vlerësimit**, me anë të së cilës kërkohet nga nxënësit të japin përgjigje sipas kriterëve të përcaktuara. Të hartosh pyetje në nivele të ndryshme të taksonomisë nuk do të thotë se ato përjashtojnë njëra-tjetrën, përkundrazi, pyetjet në këto raste ndërtohen mbi njëra-tjetrën. P.sh., një pyetje e nivelit të zbatimit kërkon që nxënësi të zbatojë një parim apo rregull, që do të thotë se ai duhet ta mbajë mend parimin (njohja), si dhe ta kuptojë atë (kuptimi). Pra, një pyetje e këtij niveli u kërkon nxënësve të përdorin shprehitë e dy niveleve poshtë saj. Pyetjet e niveleve të larta nuk i përjashtojnë pyetjet e niveleve poshtë tyre, por kërkojnë përfshirjen e shprehive të këtyre niveleve që nevojiten.

Karakteristikat e pyetjeve të njohjes

Pyetjet e njohjes, sipas studimeve të kryera, përdoren më shpesh nga mësuesit gjatë procesit mësimor. Meqenëse këto pyetje janë të rëndësishme, nuk do të thotë që të mos përdoren pyetje të niveleve të larta të të menduarit, sepse kështu do të “abuzohet” me to. Këto lloje pyetjesh i përkasin natyrës riprodhuese, që është niveli më i ulët i të menduarit. Si karakteristika të tyre mund të theksojmë:

- Edhe pse njohja është shprehje kritike e të mësuarit, pyetjet e këtij niveli përbëjnë nivelin më të ulët të taksonomisë.
- Pyetjet e njohjes kontrollojnë sesa mbajnë mend nxënësit nga faktet, përkufizimet apo vlerat gjatë procesit mësimor.
- Duke iu përgjigjur këtyre pyetjeve, nxënësit tregojnë se i mbajnë mend dhe i riprodhojnë njohuritë.

Fakti që nxënësi mban mend diçka, nuk do të thotë se ai patjetër e ka kuptuar atë. Pyetjet gojore në këtë nivel vlerësojnë aftësitë rikujtuese (saktësinë dhe sasinë e njohurive të memorizuara) dhe shkallën e njohjes

që nxënësit/kursantët kanë për një çështje të caktuar. Këto pyetje janë përgjithësisht pyetje të mbyllura, p.sh.:

- *Ç’është viskoziteti?*
- *Cilët janë katër përbërësit që përdoren për të bërë beton?*
- *A mund të bëhet artisja e bimëve në muajin gusht?*
- *Cili është emri shkencor i lules së ekspozuar (e dukshme)?*

Një pyetje gojore për të vlerësuar aftësitë rikujtuese mund të përdoret e para në serinë e pyetjeve që do të vijojnë në një nivel më të lartë vlerësues.

Pyetjet e këtij niveli duhen përdorur me kujdes, pasi nuk janë shumë të vlefshme dhe kjo nuk i detyron nxënësit që të kuptojnë në të vërtetë njohuritë (informacionin), duke i bërë ata dembelë nga ana intelektuale. Mangësi e këtyre pyetjeve është se:

- informacioni i kontrolluar e i testuar nga pyetje të këtij niveli, harrohet shpejt nga nxënësit.
- këto pyetje i referohen më shumë kujtesës sesa të kuptuarit.
- nxënësit arrijnë ta kujtojnë, duke mos e organizuar këtë informacion që marrin.

Prandaj, mësuesit duhet të bëjnë kujdes në përdorimin e pyetjeve të njohjes, pa e tepruar me to. Pyetjet e nivelit të njohjes vlerësojnë nivelin e rikujtimit, të përshkrimit, të përcaktimit, të dallimit etj.

Karakteristikat e pyetjeve të të kuptuarit

Këto lloje pyetjesh zënë një vend të ndërmjetëm në taksonominë e pyetjeve. Pyetjet e të kuptuarit nuk kontrollojnë ose vlerësojnë shprehitë e nxënësve në një nivel të lartë, por, i testojnë ata në një nivel më të lartë se pyetjet e njohjes. Pyetjet në këtë nivel kërkojnë që nxënësit ta ndryshojnë informacionin nga një formë në një tjetër dhe të përshkruajnë lidhje midis dy ose më shumë çështjeve ose ideve. Në këtë nivel vlerësohen niveli i të kuptuarit të nxënësve/kursantëve, aftësitë interpretuese ose shpjeguese si dhe aftësitë ekstrapoluese të tyre, p.sh.:

- *Formuloni me fjalët tuaja përkufizimin e OMGJ-ve (Organizma Gjenetikisht të Modifikuara), të dhënë në tekst.*
- *Bëj një skicë për të ilustruar si qarkullon Ƴaraja.*
- *Cilat janë tendencat e Ƴmimit mesatar të veshjeve të shfaqura këto vitet e fundit?*

- *Përdorni parimet e induktimit dhe të magnetizimit për të shpjeguar si punon një gjenerator.*

Karakteristikat e pyetjeve të zbatimit

Pyetjet e nivelit të zbatimit janë të gjitha ato pyetje të cilat kërkojnë që nxënësit të zbatojnë parimet apo rregullat e mësuara për të zgjidhur situata problemore. Këto lloje pyetjesh zënë një vend të mesëm në taksonominë e pyetjeve dhe kërkojnë që nxënësit jo vetëm ta mbajnë mend, por edhe ta kuptojnë informacionin dhe ta zbatojnë atë për zgjidhjen e problemeve në situata të ndryshme. Në formulimin e këtyre pyetjeve, mësuesi duhet të kujdeset që të zgjedhë probleme për të cilat nxënësit tregojnë interes për t'i zgjidhur. Shembujt e këtyre problemeve duhet të jenë të ndryshme nga ato të dhëna në mësim. Pyetjet e këtij niveli vlerësojnë nivelin e aftësive zbatuese të nxënësve në situata të reja. Këto pyetje vlerësojnë kryesisht nivelin e zbatimit, të demonstrimit, ilustrimit, imitimit, zgjidhjes, ekzaminimit, lidhjes, ndryshimit, eksperimentimit ose të zbulimit të njohurisë. Përdorimi i këtyre pyetjeve është efektiv dhe i vlefshëm vetëm kur ato kontrollojnë dhe vlerësojnë parime e shprehje të mësuara më parë. Këto pyetje gjejnë zbatim në çdo veprimtari mësimore teoriko-praktike.

Karakteristikat e pyetjeve të analizës

Pyetjet e analizës përbëjnë nën-nivelin e parë të nivelit të lartë të pyetjeve në taksonomi. Pikërisht në këtë nivel pyetjesh kërkohet nga nxënësi një nivel i lartë i të menduarit. Këto pyetje kërkojnë nga nxënësit që të zërthejnë diçka në pjesë dhe t'i analizojnë ato në veçanti, si dhe të kërkojë lidhjet midis tyre. Ndryshe nga pyetjet e të kuptuarit, për t'iu përgjigjur pyetjeve të analizës, nxënësit duhet të përdorin logjikën, kur bëjnë analiza për çështje të ndryshme. Pyetjet e këtij niveli vlerësojnë nivelin e aftësive analizuese të nxënësve, p.sh.:

- *Çfarë lidhjesh ekzistojnë midis fibrave të ndryshme sintetike që përdoren për të bërë rroba?*

Karakteristikat e pyetjeve të sintezës

Pyetjet e sintezës janë një tjetër lloj pyetjesh të nivelit të lartë, të cilat përfshijnë detyra që kërkojnë aftësi krijuese për t'u realizuar. Këto

pyetje u kërkojnë nxënësve të kombinojnë në mënyra të ndryshme atë ç'kanë nxënë më parë, për të krijuar diçka të re (produkt).

Për formulimin e këtyre pyetjeve ka teknika të ndryshme:

- Lidhja e përmbytjes së çështjeve mësimore me jetën e përditshme të botës reale.
- Lidhja e përmbytjes së çështjeve mësimore me çështje aktuale të diskutueshme, për të nxitur të menduarit e nxënësve dhe për të marrë zgjidhje të mundshme prej tyre.

Pyetjet sintezë u krijojnë liri në të shprehur nxënësve dhe kanë më shumë se një përgjigje, të cilat mësuesi i vlerëson mbi bazën e disa kritereve të përcaktuara paraprakisht. Pyetjet e këtij niveli vlerësojnë nivelin e aftësive sintetizuese të nxënësve për të formuar një model të ri, p.sh.:

- *Çfarë plani për ruajtjen e botës (jetës) së egër (bimore dhe shtazore) do të përputhej me nevojat e identifikuar nga komuniteti?*

Pyetjet sintezë përdoren për çështje që janë shumë të rëndësishme dhe janë të vështira për t'u vlerësuar.

Karakteristikat e pyetjeve të vlerësimit

Pyetjet e vlerësimit përbëjnë nivelin më të lartë të pyetjeve që mund të përdorin mësuesit në procesin mësimor. Qëllimi i hartimit dhe i drejtimit të pyetjeve të vlerësimit është që të nxiten nxënësit për të gjykuar mbi diçka: mirë/keq, e saktë/e gabuar, e rëndësishme/e parëndësishme. Për t'iu përgjigjur pyetjeve të vlerësimit, duhet të vendosen kritere për vlerësimin dhe gjykimi të bëhet sipas këtyre kritereve. Pyetjet e këtij niveli vlerësojnë nivelin e aftësive vlerësuese që kanë nxënësit/kursantët, të bazuar mbi kritere specifike dhe jo vetëm mbi opinionet e ndryshme, p.sh.:

- *Si do ta vlerësonit ju planin e propozuar të menaxhimit të fermës, duke përdorur si kriter fitimin (të ardhurat) për çdo familje?*

Pyetjet e nivelit të vlerësimit janë shumë të rëndësishme dhe nxitin të nxënësit nivele të larta të të menduarit.

Planifikimi dhe formulimi i pyetjeve për vlerësim është një domosdoshmëri, sidomos për mësuesit e rinj, pasi ato mund të shërbejnë saktësisht për të zbatuar strategjinë mësimore të zgjedhur. Më poshtë jepet një model formulari për hartimin e pyetjeve sipas niveleve të përmendura më lart, i cili shërben thjesht si shembull. Çdo mësues është i lirë të

përcaktojë modelin e vet të formularit për pyetjet, por planifikimi dhe hartimi i tyre është i padiskutueshëm për të gjithë mësimsdhënësit.

**Klasifiko çdo pyetje në nivelin e kërkuar gjatë procesit mësimor
Shëno fjalë për fjalë pyetjet. Ato të shërbejnë për të realizuar me sukses mësimin**

Llojet e pyetjeve	Numri (sasia)	Shembuj pyetjesh
Të mbyllura <ul style="list-style-type: none"> po/jo numër Kush prej jush ...? 	3	<ul style="list-style-type: none"> A ju pëlqen të jeni një trajner? Sa vëllezër keni ju? Kush prej jush flet anglisht?
Të hapura – niveli i ulët <ul style="list-style-type: none"> Rikujtim: Jep përkufizimin e.... Të kuptuarit: Si e shpjegoni ju....? Më jepni një shembull të Cila është e kundërta e ...? 	2 2	<ul style="list-style-type: none"> Cili është përkufizimi i çimentos? Cilat janë simptomat e malaries? Si e shpjegoni "nxehjen globale" për fëmijët e vegjël? Më thoni një ndryshim të rëndësishëm midis frymëmarrjes dhe fotosintezës.
Të hapura - niveli i lartë – <ul style="list-style-type: none"> Zbatimi: Përdorimet e gjërave të mësuara në situatë të reja. Analiza: Zbërthe diçka të re, analizo diçka në përputhje me kriteret. Sinteza: Krijimi i gjërave të reja nga bashkimi i pjesëve të veçanta. Vlerësimi: Vlerëso diçka qoftë edhe sipas kriterëve të tua. 	3	<ul style="list-style-type: none"> Çfarë efekti do të ketë nxehja globale në vitet e ardhshme? Cilat janë epërsitë dhe mangësitë e pjesëmarrjes në nivel të lartë të fermerëve në zhvillimin rural? Çfarë duhet bërë për të minimizuar efektet e nxehjes globale?
Numri total i pyetjeve	10	

Shembuj e pyetjeve të vendosura në tabelë janë dhënë thjesht si tipike për tipin dhe nivelin e pyetjeve, pra nuk i janë referuar një teme apo çështjeje të caktuar mësimore.

Ecuria metodike e përpilimit të pyetjeve gojore

Përpilimi ose përgatitja e pyetjeve gojore kalon në këto faza:

I. Planifikimi i pyetjeve gojore për vlerësim

Përpilimi i pyetjeve kërkon aftësi dhe përgatitje, prandaj një mësues i përgatit ato më parë. Të tjerë janë të aftë që t'i përpilojnë në çast. Parapërgatitja e pyetjeve garanton suksesin për të qenë pyetës të mirë.

II. Drejtimi i pyetjeve gojore për vlerësim

Në këtë fazë zakonisht pyetjet i drejton mësuesi, por edhe nxënësit duhen lejuar të bëjnë pyetje për të vlerësuar njëri-tjetrin. Ka teknika të ndryshme për drejtimin e pyetjeve. Një teknikë është adresimi i pyetjeve gojore gjithë klasës; më tej duhet të presim aq kohë sa klasa të mendojë për përgjigjen dhe pastaj të thërrasim dikë për t'u përgjigjur. Sipas kësaj teknike, të gjithë nxënësit mendojnë për përgjigje në mënyrë individuale, pra nuk qëndrojnë pasivë. Në rastet kur pyetja nuk kuptohet nga nxënësit, atëherë është mirë që pyetja të mos përsëritet, por të strukturohet dhe të përdoren materiale të ndryshme për ta sqaruar atë, deri sa të marrim një përgjigje. Drejtimi i pyetjeve të hapura në nivele të ndryshme krijon mundësi për përfshirjen e të gjithë nxënësve në përgjigje dhe jo diskriminimin (veçimin) e tyre.

Një teknikë tjetër për drejtimin e pyetjeve është sondazhi. *Sondazhi* është teknika për të "gërmuar" në mendjen e nxënësve dhe për të parë se çfarë fshihet aty. Ai realizohet sipas kësaj skeme:

Qetësia: - U lihet kohë nxënësve të mendohen.

Inkurajimi: - "Ju lutem vazhdoni.....".

Qartësimi: - "Çfarë doni të thoni me.....".

Përpunimi: - "Më thoni më tepër.....".

Shembuj: - "A mund të më jepni shembuj aktualë të kësaj".

III. Trajtimi dhe vlerësimi i përgjigjeve të nxënësve

Gjëja më delikate dhe më e rëndësishme për t'u bërë gjatë vlerësimit, është dëgjimi dhe reagimi ndaj përgjigjeve. Mësuesi të ndryshëm reagojnë në mënyra të ndryshme ndaj përgjigjeve të nxënësve. Katër mundësitë e përgjigjeve dhe reagimet e mësuesit/instruktorit janë:

1. *Nxënësi jep përgjigje të saktë:* Mësuesi në këtë rast është mirë të lavdërojë nxënësin dhe ta fiksojë atë për dhënien e përgjigjes së saktë. Vlerësimi mund të bëhet në krahasim me standardin e vendosur në objektivat.

2. *Nxënësi jep përgjigje pjesërisht të saktë:* Mësuesi në këtë rast vlerëson nivelin e pjesës së saktë të përgjigjes dhe kërkon përgjigje nga të tjerët për ta plotësuar atë.

3. *Nxënësi jep përgjigje jo të saktë:* Mësuesi në këtë rast vlerëson nxënësin për kontributin e dhënë, pa bërë komente rreth përgjigjes dhe kërkon nga të tjerët përgjigjet e saktë.

4. *Nxënësi nuk përgjigjet:* Mësuesi gjendet në një situatë shumë të vështirë, prandaj rekomandohen sugjerimet e mëposhtme:

- Formulimi i pyetjes me fjalë të tjera më të thjeshta.
- Përdorimi i materialeve të dukshme për ta sqaruar pyetjen.
- Bërja të ditur nxënësve se përgjigjen mund ta gjejnë në materialet e referencave.
- Përdorimi i mimikës për t'i motivuar nxënësit që të reagojnë.

Faktorët që ndikojnë në formulimin dhe drejtimin e pyetjeve gojore dhe keqpërdorimi i tyre në vlerësim

Formulimi i pyetjeve kushtëzohet nga:

- objektivat mësimorë të lëndës;
- veçoritë e lëndës;
- përvoja e mësuesit dhe formimi i tij psiko – pedagogjik;
- përvoja dhe nevojat e nxënësve;
- shkalla e vështirësisë së temës mësimore;
- sasia (numri) e pyetjeve;
- koha në dispozicion për të pyeturit;
-etj.

Me gjithë rëndësinë e padiskutueshme që kanë pyetjet gojore gjatë realizimit të procesit mësimor, nuk duhet që ato të përdoren me tepri. Rastet kur mund të themi se i kemi keqpërdorur ato janë:

- kur drejtohen pyetje të vështira, tej perceptimit të nxënësve;
- kur përfshihen disa pyetje në një fjali pyetëse;
- kur këmbëngulet mbi pyetjen, për të marrë përgjigjen e menduar nga mësuesi/instruktori;
- kur caktohet kohë e pamjaftueshme për të marrë përgjigjen;
- kur, në shumë raste, padurimi ose mungesa e besimit të nxënësit bën që mësuesi të pyesë dhe të përgjigjet vetë.

Të pyeturit vazhdon të përdoret, me gjithë ndryshimet e sotme në teknologjinë mësimore. Këtu u dhanë disa prej teknikave praktike për pyetjet, po ka edhe teknika e strategji të tjera për të pyeturit. Qëllimi ynë është që të zotëroni shprehitë e përdorimit të teknikave të të pyeturit, për të qenë në gjendje t'i përdorni ato. Sa herë që t'ju drejtoni pyetje nxënësve, duhet të kujtoni se çfarë jeni duke bërë me ta.

Literatura:

- Bejtja, Pajtim: *Kontrulli i dijës*. (Material i pabotuar)
- Buci, Albina: *Përdorimi i pyetjeve gojore, teknikë mësimore efektive*, buletini "Arsimi dhe Formimi Profesional" Nr 4, Tiranë, 2003.
- Materiale të TITI-it (Training Institute for Technical Instruction), Nepal, për trajnimin e trajnerëve, 2003.
- Musai, Bardhyl: *Metodologji e mësimdhënies*, Tiranë, 2003.

Parimi i “vlefshmërisë” në vlerësimin e nxënësve në AFP

Mirela ANDONI
Instituti i Kurikulave dhe i Trajnimit

Procesi i mësimdhënies nuk mund të kuptohet pa marrë parasysh vlerësimin për atë që nxënësi ka arritur si dhe vlerësimin për atë që mësuesi i ka ofruar auditorit. Në një kuptim figurativ, vlerësimi i qëndron pas procesit të mësimdhënies.

Procesi i vlerësimit të nxënësit është gjykimi mbi shkallën e përmbushjes së objektivave mësimorë nga ana e tij, pas një informacioni të marrë në lidhje me të. Nxënësve u vlerësohen njohuritë, shprehitë dhe qëndrimet ose, në mënyrë të integruar, u vlerësohen kompetencat (performanca). Marrja e informacionit për nivelin e përmbushjes së objektivave mësimorë bëhet me forma, metoda dhe instrumente vlerësimi të ndryshme. Nëpërmjet tyre realizohet krahasimi i karakteristikave të nxënësit me kriteret (standardet), të cilat më pas i lejojnë vlerësuesit (mësuesit) të japë gjykimin përkatës. Në procesin e vlerësimit themi që nxënësi X kalon klasën apo nxënësi Y është kompetent. Të gjitha sa më sipër janë vlerësime që vijnë si rezultat i vëzhgimeve dhe i matjeve të arritjeve të nxënësve me kritere (që mund të jenë standarde reale, imagjinare, të rreme (false) apo të ndryshueshme, të dukshme apo të fshehta) dhe në këtë mënyrë kemi dhënë një gjykim.

Kjo do të thotë se ***objektivat mësimorë duhet të shprehen në formë kriteresh vlerësimi***, që mundësojnë vlerësimin (gjykimin) e shkallës së përmbushjes së tyre nga ana e nxënësit.

Karakteristikat themelore që duhet të zotërojë një vlerësim i mire janë: vlefshmëria, besueshmëria, paanshmëria dhe autenticiteti. Më poshtë do të shqyrtojmë parimin e “vlefshmërisë”.

Parimi i vlefshmërisë

Vlefshmëria në vlerësimin e nxënësve nënkupton sa mirë një vlerësim ka matur apo vlerësuar atë që është parashikuar të matet. Me fjalë të tjera, mund të themi sa përputhet vlerësimi me objektivat mësimorë të parashikuar për t'u vlerësuar.

Faktorët që ndikojnë në vlefshmërinë e vlerësimit janë:

- Përcaktimi i qartë i detyrës (përmbajtjes) që do të vlerësohet;
- Mënyra se si ndërtohet vlerësimi (çfarë metodash e instrumentesh do të përdoren për vlerësimin e nxënësit);
- Kriteret që vendosen për vlerësimin e detyrës (për vlerësimin e arritjes se nxënësit në përputhje me objektivat mësimorë).

- Gjatë çdo vlerësimi nxënësit i kërkohet të përmbushë një ose disa detyra apo veprimtari. ***Përcaktimi qartë i detyrës që do të vlerësohet*** duhet të përputhet me objektivin mësimor, pra ***procesi i vlerësimit*** të një detyre është i vlefshëm atëherë kur:

- reflekton njohuritë ose arritjet aktuale të nxënësit;
- vlerëson atë që është parashikuar të vlerësohet dhe që përputhet me objektivat mësimorë;
- merr përsipër dhe motivon nxënësin të paraqesë më të mirën nga arritja e tij;
- është në përputhje me njohuritë dhe shprehitë e fituara në procesin mësimor;
- është parë nga ekspertët për të gjykuar cilësinë dhe autenticitetin e përmbajtjes së vlerësimit.

Ndërhyrja e faktorëve të tjerë gjatë procesit të vlerësimit, që nënkupton vlerësimin e elementeve që kanë të bëjnë me shprehitë demonstruese dhe jo të atyre që realisht nxënësi duhet të dijë dhe të bëjë, ul vlefshmërinë. Shembuj të ndërhyrjes së faktorëve të jashtëm në vlerësim janë, p.sh., shprehitë për të lexuar e shkruar; loja me role; të kuptuarit e përmbajtjes; personaliteti dhe kufizimet fizike.

Përzgjedhja e instrumentit të duhur për vlerësimin dhe ndërtimi i këtij instrumenti sipas kriteve, ndikojnë në vlefshmërinë e vlerësimit. Këtu ka një rëndësi përzgjedhja e instrumentit në varësi të asaj që do të vlerësohet (njohuri, shprehje; produkt/proces, qëndrim). Për të gjykuar arritjen e nxënësit përdoren instrumente të ndryshme:

Instrumentet e vlerësimit	Vlerësimi i shprehive		Vlerësimi i njohurive	Vlerësimi i qëndrimeve
	Vlerësimi i procesit	Vlerësimi i produktit		
Pyetje-përgjigje me gojë, të hapura.			◆	
Pyetje-përgjigje me gojë, të mbyllura.			◆	
Pyetje-përgjigje me shkrim, të hapura (ese).			◆	
Pyetje-përgjigje me shkrim, të mbyllura (me zgjedhje të shumëfishtë, me plotësim, me kombinim).			◆	
Detyra me shkrim (ushtrime, skica, problema)			◆	
Studime të rastit	◆	◆	◆	◆
Projekte praktike	◆	◆	◆	◆
Lojë me role	◆	◆	◆	◆
Listë kontrolli	◆	◆	◆	◆

Kriteret për përzgjedhjen e metodave dhe të instrumenteve të vlerësimit

Në përzgjedhjen e metodave dhe të instrumenteve të vlerësimit ndikojnë shumë faktorë. Sigurisht që faktori përcaktues është ajo se çfarë do të vlerësohet: shkalla e përvetësimit të njohurive, shkalla e formimit të shprehive, mënyra e të sjellit në rrethana të caktuara ose performanca e nxënësit në tërësi, që tregon nivelin e kompetencave që ai zotëron. Instrumentet e ndryshme me pyetje-përgjigje me shkrim ose me gojë japin informacion të mjaftueshëm për të gjykuar për nivelin e përvetësimit të njohurive, por nuk tregojnë asgjë në lidhje me shprehitë. Një listë-kontrolli e strukturuar mirë ndihmon në vlerësimin e produktit dhe të procesit të punës kundrejt kritereve dhe standardeve përkatëse, por nuk jep informacion në lidhje me njohuritë e nxënësve.

Ka edhe faktorë të tjerë që ndikojnë në përzgjedhjen e instrumenteve të vlerësimit, të tilla si koha në dispozicion, kushtet në të cilat do të kryhet provimi ose testimi, numri i nxënësve që do të vlerësohen, mundësitë financiare etj.

- **Hartimi i kritereve të vlerësimit** merr parasysh objektivat mësimorë. Dekodimi i objektivave mësimorë, pra kthimi i tyre në të matshme, ndihmon në përcaktimin dhe formulimin e drejtë të njësive të testit, kur instrumenti i përzgjedhur i vlerësimit është test; ose të listës së kontrollit, në rastin e vlerësimit të procesit të punës.

Kur diskutojmë për vlefshmërinë e vlerësimit, duhet të analizojmë disa faktorë të tjerë që ndikojnë jo vetëm në vlefshmërinë, por edhe në besueshmërinë e vlerësimit, si:

a. Mënyrën se si do të organizohet vlerësimi, administrimi (p.sh., testi), për të cilin duhen marrë parasysh:

- **Koha:** nëse kjo është e mjaftueshme për të dhënë një përgjigje sa më të plotë. Duhet të merren parasysh llojet e pyetjeve në rastin e vlerësimit të njohurive dhe lloji i shprehisë praktike, në rastin e

vlerësimit të një detyre pune. Koha duhet të respektojë nxënësit me shkathtësi të ndryshme.

- **Ndershmëria:** a kanë punuar të gjithë ata që vlerësohen në të njëjtat kushte dhe me të njëjtat burime informacioni, pa shfrytëzuar burime të tjera të palejueshme;
- **Paanshmëria:** nëse ka ndihmuar administruesi i vlerësimit ata që do të vlerësohen;
- **Gabimet në vendosjen e pikëve:** a janë llogariturat të gjitha pikët në mënyrë korrekte;
- **Kushtet e zhvillimit të vlerësimit:** a ndikon hapësira, temperatura, koha e zhvillimit (mëngjes, drekë..) në performancën e nxënësit.

b. Nxënësin

Shqyrtohen:

- **Emocionet:** a kanë të gjithë ata që vlerësohen të njëjtat emocione;
- **Motivimi:** a janë të gjithë nxënësit mjaftueshëm seriozë gjatë vlerësimit, për të dhënë maksimumin e tyre.

c. Ndërtimin e instrumentit që përdoret për vlerësim

Shqyrtohen:

- **fusha që vlerësohet:** a përputhet me objektivin dhe përmbajtjet mësimore;
- **instrumenti i përzgjedhur:** a përputhet me shprehinë apo njohurinë që do të vlerësohet;
- **ffjalori që përdoret:** a i përgjigjet nivelit të nxënësve;
- **formulimet:** a janë të sakta për të mos lejuar shumë interpretime;
- **çelësi i përgjigjes:** është e sigurt që kjo përgjigje nuk merret dhe nga pyetje të tjera;
- **numri i çështjeve të testit** (sasia e kërkesave në listën e kontrollit): a është i mjaftueshëm për të dhënë një gjykim të saktë për arritjen e performancës;
- **qëllimi i vlerësimit:** a përfshihen në vlerësim të gjithë objektivat që duhet të vlerësohen (përfshirë këtu edhe ata që janë të pamatshëm, a janë kthyer në të matshëm.

Përdorimi i koncepteve të vlefshmërisë në planifikimin dhe ndërtimin e instrumenteve efektive të vlerësimit

- Për të planifikuar një vlerësim të vlefshëm, duhet të fokusohemi:
 - në vlefshmërinë e përmbajtjes së instrumentit të vlerësimit, që i referohet faktit se sa përmbajtja e instrumentit të përzgjedhur të vlerësimit i përgjigjet përmbajtjes së trajtuar ose detyrës së punës;
 - në vlefshmërinë e ndërtimit të instrumentit të vlerësimit, që i referohet faktit se sa përmbajtja e instrumentit të përzgjedhur të vlerësimit i përgjigjet jo vetëm volumit të përmbajtjes që trajtohet gjatë procesit mësimor, por edhe kohës që shtrihet dhënia e kësaj përmbajtjeje.

Për këtë arsye, ka rëndësi që gjatë planifikimit dhe ndërtimit të instrumentit të përzgjedhur të vlerësimit të përdoret tabela e specifikimeve, që siguron vlefshmërinë e përmbajtjes dhe të formës së vlerësimit. Tabela e specifikimeve, në fakt është plani i një vlerësimi, që e ndihmon hartuesin e instrumentit të vlerësimit të marrë parasysh se sa peshë duhet te kenë përmbajtje dhe shprehje të caktuara.

Kjo tabelë u jep përgjigje pyetjeve:

1. Sa pyetje ka në një test;
2. Cilat fusha të përmbajtjes zënë më shumë vend në testim;
3. Cilat fusha të përmbajtjes zënë më pak vend në testim;
4. Cilat shprehje janë më shumë në vëmendje;
5. Cilat shprehje zënë më pak vend në testim;

Shembull

Tabela e specifikimeve

Çështje/Tema	Pesha lëndore	Të kuptuarit	Analizë	Zbatim në situata të reja	Numri i pyetjeve	Pesha në %
Tema 1	6.85	1	0	0	1 objektive	6.85
Tema 2	7.53	1	1	0	1 objektive 1 subjektive	3.765 3.765
Tema 3	6.16	1	1	0	1 objektive 1 subjektive	3.08 3.08
Tema 4	4.79	0	1	0	1 subjektive	4.79
Tema 5	3.43	0	1	0	1 subjektive	3.43
Tema 6	7.53	1	1	0	1 objektive 1 subjektive	3.765 3.765
Tema 7	8.21	1	1	0	1 objektive 1 subjektive	2.736 5.473
Tema 8	3.43	0	1	0	1 subjektive	3.43
Tema 9	6.85	1	1	0	1 objektive 1 subjektive	3.425 3.425
Tema 10	10.28	1	1	0	1 objektive 1 subjektive	3.426 6.853
Tema 11	5.48	0	1	0	1 subjektive	5.48
Tema 12	1.37	0	1	0	1 subjektive	1.37
.....
Totali	100	9	15	1	25	100

Literatura:

- Andoni Mirela: *Parimet dhe prirjet në vlerësimin e nxënësve në arsimin dhe formimin profesional*, Buletini “Arsimi dhe Formimi Profesional”, 9. 2006.
- Mager Robert F.: *Measuring Instructional Results*, 1997, SHBA.
- Grup autorësh: *Si të hartojmë një test*, 2002, Tiranë.
- Mustafai Alqi: *Vështirësi i përgjithshëm për vlerësimin e nxënësve në arsimin dhe formimin profesional*, Buletini “Arsimi dhe Formimi Profesional”, 9. 2006.

Parimi i “autenticitetit” në vlerësimin e nxënësve në AFP

Mirela ANDONI
Instituti i Kurikulave
dhe i Trajnimit

Hyrje

Procesi i të mësuarit në shkollë gjithmonë shoqërohet me vlerësimin e asaj që nxënësi ka arritur si dhe të asaj që mësuesi ka ofruar gjatë procesit të mësimdhënies. Vlerësimi konsiderohet si një pjesë e rëndësishme e procesit mësimor dhe vazhdimisht bëhen përpjekje për të zvogëluar elementet e subjektivitetit në të.

Një vlerësim konsiderohet i mirë kur ai bazohet në disa karakteristika, si:

- *Vlefshmëria*, që nënkupton sa mirë një vlerësim ka matur atë që është parashikuar të matet;
- *Besueshmëria*, që nënkupton sa të qëndrueshme janë rezultatet e vlerësimit të një grupi me karakteristika të njëjta në kohë të ndryshme;
- *Paanshmëria*, që nënkupton një vlerësim të mirë dhe mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit;
- *Autenticiteti*, të cilin do ta trajtojmë më poshtë.

Kuptimi për autenticitetin në vlerësim

Një vlerësim nuk mund të jetë efektiv nëse realizohet duke testuar një shprehje të izoluar apo vetëm të mbajturit mend të fakteve. Për të vlerësuar në mënyrë të plotë dhe të saktë atë që një person realisht ka

nxënë, ka rëndësi që metodika e vlerësimit të shqyrtojë (ekzaminojë) shprehitë e tij në tërësi, që në fakt nënkupton **vlerësimin autentik**.

Vlerësimi autentik është një formë vlerësimi gjatë të cilit nxënësit i kërkojnë të përmbushë një detyrë nga bota reale e punës, detyrë që mishëron një zbatim kuptimplotë të njohurive dhe të shprehive kryesore që ai zotëron.

Vlerësimi autentik e ballafaqon nxënësin me sfidat e botës reale dhe kërkon prej tij përdorimin e shprehive dhe të njohurive përkatëse të situara gjatë procesit mësimor.

Epërsitë e vlerësimit që merr parasysh parimin e “autenticitetit”

Vlerësimi autentik ka disa epërsi, që janë:

- ✓ Përfshirja e nxënësve në një përvojë të botës reale të punës;
- ✓ Përdorimi nga nxënësi i njohurive, informacioneve dhe shprehive që nevojiten për të zgjidhur probleme reale dhe autentike;
- ✓ Kërkesa që nxënësi të konsolidojë dhe të zbatojë njohuri.
- ✓ Fokusimi në procese të menduarit krijues.
- ✓ Përfshirja e një llojshmërie të aktiviteteve vlerësuese, të përcaktuara nga profili i nxënësit dhe stilet e të nxënës.
- ✓ Vlerësimi i një performace të gjerë dhe komplekse;
- ✓ Kërkesa që nxënësi të krijojë, në krahasim me zgjedhjen e një përgjigjeje;
- ✓ Kërkesa që nxënësi të demonstrojë një set (paketë) shprehish dhe sjelljesh.
- ✓ Ekzaminimi njëkohësisht i procesit dhe i rezultateve të të nxënës.
- ✓ Kërkesa që mësuesi të njohë dëshirat e nxënësve si dhe çfarë nxënësi është në gjendje të bëjë pas procesit të të nxënës, në mënyrë që të hartojë apo të përzgjedhë një detyrë vlerësuese autentike.
- ✓ Kërkesa që mësuesi të planifikojë veprimtari vlerësuese që të jenë në pajtim me pjesën e mësim.

Vlerësimi autentik është një vlerësim që bazohet në kriteret dhe jo në krahasimin e nxënësve me njëri-tjetrin.

Vlerësimi autentik siguron vlefshmërinë e kurrikulës dhe minimizon ndërhyrjen e mësuesit apo të faktorëve të tjerë të jashtëm në vlerësim, duke ulur subjektivitetin e tij.

Faktorët që ndikojnë në zhvillimin e një vlerësimi autentik

Faktorët që ndikojnë në zhvillimin e një vlerësimi autentik janë:

- ✓ Lloji i detyrës apo i projektit që i jepet nxënësit për t'u vlerësuar duhet të jetë në përputhje me informacionin që është dhënë në shkollë;
- ✓ Koha në dispozicion, si për mësuesin që kryen vlerësimin autentik, ashtu dhe për nxënësin që do të realizojë detyrën;
- ✓ Kompaktësia e grupit të përzgjedhur të nxënësve;
- ✓ Vendosja e kriterëve të qarta për vlerësimin e detyrës/projektit të dhënë.

Dallimet midis vlerësimit tradicional dhe vlerësimit autentik

Në një vlerësim të ashtuquajtur tradicional nxënësi në përgjithësi do të duhet të bëjë një përzgjedhje të detyruar, që i ofrohet nga testet e parapërgatitura, të cilat janë, në përgjithësi, me zgjedhje të shumfishtë apo me plotësim, zgjedhje e drejtë e gabuar etj.

Modeli i vlerësimit tradicional bazohet kryesisht në vlerësimin e njohurive dhe më pak në atë të shprehive.

Vlerësimi autentik bazohet në arsyet dhe praktikatat e mëposhtme:

1. Misioni i shkollës është të përgatisë qytetarë produktivë;
2. Që një individ të jetë produktiv, duhet që të jetë i aftë të përmbushë detyra që i referohen botës reale;
3. Për këtë arsye shkolla duhet t'i ndihmojë nxënësit për të qenë të aftë për të përmbushur detyra të cilat do t'u krijojnë atyre më shumë mundësi përshtatjeje në tregun e punës pas diplomimit.

4. Për të qenë e suksesshme, shkolla duhet të kërkojë nga nxënësit përmbushjen e detyrave që i ballafaqojnë ata me sfidat e botës së punës, duke i vënë ata përpara përgjegjësi të reale.

Vlerësimi autentik është plotësues i vlerësimit tradicional.

Dallimet midis vlerësimit tradicional dhe atij autentik:

Tradicional.....Autentik

Përzgjedhje e përgjigjes.....Përmbushje detyre

I parapërgatitur..... Bota reale
(është i detyruar të bëjë një punë)

Riprodhim/ të mbajturit mend.....Zhvillim/ zbatim

I strukturuar nga mësuesi.....I strukturuar nga nxënësi

Tregues i tëthortë (i arritjes së nxënësit).....Tregues i drejtpërdrejtë

Ndryshe nga testi i zakonshëm, ku nxënësi vihet para zgjedhesh të parapërgatitura, në vlerësimin autentik nxënësit i kërkohet të demonstrojë të kuptuarin nëpërmjet një detyre komplekse.

Emra alternative për vlerësimin autentik

Vlerësim autentik = Vlerësim i performancës

Quket ndryshe kështu, pasi nxënësit i jepet një detyrë konkrete për t'u përmbushur.

Vlerësim autentik = Vlerësim alternativ

Është një alternativë e vlerësimit tradicional.

Vlerësim autentik = Vlerësim i drejtpërdrejtë

Quket kështu, pasi vlerësimi autentik paraqet në mënyrë më të drejtpërdrejtë treguesit e zbatimit të njohurive dhe të shprehive të nxënësit gjatë përmbushjes së një detyre konkrete.

Literatura:

- Andoni Mirela: *Parimet dhe prirjet në vlerësimin e nxënësve në arsimin dhe formimin profesional*, Buletini "Arsimi dhe Formimi Profesional", 9. 2006.
- Mager Robert E: *Measuring Instructional Results*, 1997, SHBA.
- Grup autorësh: *Si të hartojmë një test*, 2002, Tiranë.
- Mustafai Alqi: *Vështrim i përgjithshëm për vlerësimin e nxënësve në arsimin dhe formimin profesional*, Buletini "Arsimi dhe Formimi Profesional", 9. 2006.

Parimi i “prakticitetit” në vlerësimin e nxënësve në AFP

Alqi MUSTAFAI
Agjencia Kombëtare e Arsimit
dhe e Formimit Profesional

Kuptimi i “prakticitetit” në vlerësimin e nxënësve

Vlerësimi i nxënësve karakterizohet nga shumë tipare (saktësia, besueshmëria, paanshmëria, vlefshmëria etj.) dhe një “vlerësim i mirë” është ai që i përmbush maksimalisht kërkesat për tiparet e përmendura më sipër dhe i “jep nxënësit atë që ai meriton”. Por, procesi i vlerësimit ka edhe aspekte të tjera që lidhen me kostot për konceptimin dhe realizimin, me kushtet për realizim, me kërkesat për burime njerëzore ose për mjete teknologjike të caktuara, për afate etj. Të gjitha këto kërkesa, në mënyrë të përmbledhur, shprehin atë që quhet “*prakticitet*” në vlerësimin e nxënësve. Ky parim e karakterizon vlerësimin nga pikëpamja e mundësive të zbatimit, për të arritur objektivat e duhur të vlerësimit. Një instrument vlerësimi është **praktik**, atëherë kur ka kushte dhe mundësi zbatimi me parametrat e kërkuar dhe një vlerësim është vërtet **i mirë**, atëherë kur, jo vetëm përmbush kriteret e tjera, por kur është edhe praktik (i mundshëm për zbatim). P.sh., një test teorik me pyetje me zgjedhje të shumëfishta, që përmban 250 njësi testi, sigurisht që është i vlefshëm dhe i besueshëm, pasi u referohet pothuaj të gjithë objektivave të lëndës, por mund të mos jetë praktik, pasi ka shumë njësi testi, që kërkojnë shumë kohë për t’u plotësuar nga nxënësi.

Rëndësia e “prakticitetit” në vlerësimin e nxënësve

Prakticiteti është mjaft i rëndësishëm kur konceptohet procesi i vlerësimit të nxënësve. Ai duhet pasur parasysh si në përzgjedhjen e

instrumentit të vlerësimit, ashtu edhe në planifikimin e administrimit të procesit. Ka raste të mosmarrjes parasysh të këtij kriteri, që kanë çuar në dështimin e procesit të vlerësimit. Mësuesit kanë prirje që të bëjnë vlerësime shumë “të përpikta” dhe të hollësishme, me shumë instrumente vlerësimi, që i vlerësojnë nxënësit për një kompleksitet objektivash mësimorë, mbështetur në kriteret vlerësimi të hollësishme. Kjo kërkon shumë punë përgatitore, shumë vlerësues, shumë kohë, shumë mjedise dhe mjete dhe, ndonjëherë, shumë para. Analiza e procesit të vlerësimit, duke i baraspeshuar kërkesat e vlerësimit me mundësitë praktike dhe reale për zbatim, bën që edhe vlerësimi të modifikohet dhe t’i afrohet realitetit konkret të shkollave.

Faktorët që ndikojnë në “prakticitetin” e vlerësimit të nxënësve

Thelbi i analizës së “prakticitetit” të një vlerësimi të nxënësve është krahasimi i “*nevojave*” për një vlerësim të mirë, me “*mundësitë*” reale për ta arritur atë. Nga ky ballafaqim merret vendimi përfundimtar për ta zbatuar vlerësimin e konceptuar fillimisht apo për ta modifikuar (thjeshtuar) atë që të bëhet i pranueshëm, por edhe të plotësojë kërkesat e tjera cilësore. Janë disa faktorë kryesorë që merren parasysh për të analizuar një instrument vlerësimi dhe procesin e realizimit të vlerësimit:

- qëllimi, natyra dhe tipi i vlerësimit;
- shpeshësia e vlerësimit;
- kompleksiteti, gjerësia dhe thellësia e asaj që do të vlerësohet (njohuri, shprehje, qëndrim, kompetencë);
- nevoja për mjedise ku do të kryhet vlerësimi;
- numri i nxënësve që do të vlerësohen;
- nevoja për burime njerëzore (hartues, administratorë, korrigjues, etj.);
- nevoja për dokumentacione dhe burime materiale për vlerësimin;
- koha e nevojshme;
- burimet e nevojshme financiare etj.;

Planifikimi i vlerësimit bëhet duke analizuar paralelisht si kërkesat cilësore, ashtu edhe mundësitë e zbatimit, për të arritur në një zgjidhje optimale të këtij procesi.

Vlerësimi i produktit të punës së nxënësve në AFP

Lindita DHIMA
Agjencia Kombëtare e Arsimit
dhe e Formimit Profesional

Hyrje

Ndryshimi kryesor ndërmjet arsimit të përgjithshëm dhe atij profesional është roli që luan përmbushja (realizimi/kryerja) në vlerësimin e nxënësve/kursantëve. Në arsimin e përgjithshëm, njohuritë janë më të rëndësishme dhe testimi i njohurive është tipik. Në arsimin dhe formimin profesional njohuritë janë të rëndësishme dhe ato, gjithashtu, testohen, por, për sa kohë që fokusi (synimi) janë shprehjet praktike (kompetencat), atëherë testimi i përmbushjes (performancës) është më i rëndësishëm. Testimi i përmbushjes tregon nëse nxënësi e ka fituar shprehinë (kompetencën) dhe nëse mund ta ushtrojë (përmbushë) atë (kompetencën) me efektivitet (me rezultat) dhe pa rrezik (me siguri). Me fjalë të tjera, testimi i duhur i përmbushjes tregon nëse nxënësi është aq kompetent sa ta përmbushë të njëjtën kompetencë në jetën reale.

Çfarë kuptojmë me përmbushje?

***Përmbushja** është një proces i vëzhgueshëm, i cili kërkon njohuri, shkathtësi/shprehje dhe qëndrime për të kryer diçka, brenda një standardi të pranueshëm përmbushjeje dhe që çon në nxjerrjen e një produkti, në kryerjen e një shërbimi ose në marrjen e një vendimi.*

Produkti përfundimtar

Ka plot raste gjatë procesit të të nxënësve të shkathëtëve/shprehive, kur mësuesi/instruktori ka nevojë të shikojë vetëm produktin e mbaruar,

për të gjykuar mbi cilësinë e përmbushjes nga nxënësi. Për shumë detyra, produkti është më i rëndësishëm se procesi. Vlerësimi i një produkti kryhet ndryshe nga vlerësimi i procesit. Me gjithë ngjashmërinë me udhëzuesin e përmbushjes, **instrumenti i shkallëzuar i vlerësimit të produktit** ka dallime thelbësore.

Le të fillojmë me përkufizimin e fjalës produkt:

Produkti është një objekt i krijuar ose një shërbim i realizuar gjatë përmbushjes së një detyre.

Produkti mund të jetë një objekt që mund ta shohim, një ushqim që mund t'i provojmë shijen dhe ta nuhasim, një veshje që mund ta prekim ose një muzikë që mund ta dëgjojmë. Produkti mund të jetë edhe shërbim. Mjeku bën një kontroll fizik. Mekaniku inspekton një motor. Këtu nuk kemi ndonjë produkt konkret, po vetëm një shërbim. Por, qoftë kur është një objekt, qoftë kur është një shërbim, produkti mund të matet me objektivitet (me paanësi). Ne, si instruktorë dhe ekspertë të një fushe profesionale, shpesh, edhe me një hedhje të syrit, mund të themi nëse një objekt është në rregull ose jo. Kjo, për shkak të përvojës shumëvjeçare që kemi. Nxënësit tanë nuk e kanë këtë përvojë. Prandaj, ne duhet t'i ndihmojmë ata të kuptojnë dhe të mësojnë se si mund të vlerësohet një produkt me anën e kriterëve specifike (të veçanta).

Kur përdoret dhe si kryhet vlerësimi i një produkti

Vlerësimi i një produkti bëhet nëse:

- rezultati është më vendimtar se procesi;
- ka më shumë se një proces;
- procesi nuk mund të vëzhgohet lehtë (për shembull: zhvillimi i një filmi në dhomën e errët).

Për vlerësimin e një produkti ndiqet kjo procedurë:

1. Përcaktohet qartë shprehia praktike. Shprehia duhet të shkruhet që në fillim të instrumentit të vlerësimit dhe duke përdorur të njëjtat fjalë, me të cilat ajo është përshkruar në programin mësimor.
2. Përcaktohen kushtet e testit. Informohen nxënësit se çfarë (mjetesh, pajisjesh, veglash, burimesh energjie etj.) do të lejohen

ose nuk do të lejohen të përdorin. A do të zhvillohet testi në laborator apo në një vend aktual pune? A do të lejohet përdorimi i veglave të dorës apo i atyre të mekanizuara? A do të jenë gati për punë mjetet dhe pajisjet, apo mbledhja dhe përgatitja për punë e tyre do t'i kërkohej nxënësit si pjesë e testit? Të gjitha këto pyetje duhet të marrin përgjigje të shkurtër në fillim të instrumentit të vlerësimit.

3. Listohen kriteret e rëndësishme për produktin. **Kriteret** përkufizohen si *karakteristika ose veti specifike të një objekti - i cili mund të vëzhgohet ose të matet -, që kanë të bëjnë me cilësinë dhe që ndihmojnë në ndarjen e objekteve në "të mira" dhe në "jo të mira"*.

Si shembull, le të supozojmë se shprehia është "përgatitja e pilafit".

Cilat janë kriteret për një "pilaf të gatuar mirë?" Ja disa prej tyre:

- shija,
- temperatura në të cilën shërbehet,
- prania e materialeve të huaja,
- paraqitja,
- struktura,
- palëvizshmëria.

Për çdo shprehje, në program përdoren të njëjtat kriterë që përdoren në botën profesionale reale.

Ku gjenden këto kriterë? Përvoja e instruktorit është fillimi më i mirë. Pyeten instruktorët e tjerë për të kontrolluar listën e kriterëve. Tekstet shkollore mund të vijnë në ndihmë, gjithashtu. Mund të gjendet informacion nga një analizë detyre (DACUM, analizë profesioni etj.). Instruktori pyet veten: "A kam vendosur në listë çdo gjë, që mund të përdoret për të dalluar një objekt të mirë nga një jo i mirë?"

4. Formulohet sa më qartë të jetë e mundur secili prej kriterëve.

Ndiqen udhëzimet e mëposhtme për çdo kriter:

- Shkruhet çdo kriter qartë dhe thjeshtë, duke përdorur terma të botës së punës. Normalisht, një ose dy fjalë janë të mjaftueshme.
- Listohen të gjitha kriteret në një renditje logjike. Renditja, në rastin e shembullit tonë të pilafit, mund të jetë ajo, me të cilën konsumatori i një restoranti do të vlerësonte pjtën që i shërbehet.

5. Bëhet një listë me gjatësi të arsyeshme. Për një produkt duhet të ketë një minimum prej 4 ose 5 kriteresh dhe jo më shumë se 10-15, nëse është e mundur.
6. Vendoset një shkallëzim për vlerësimin. Instrumenti i shkallëzuar i vlerësimit të produktit ka një hapësirë për vlerësimin e çdo kriteri. Ekzistojnë shumë lloje shkallëzimesh që mund të përdoren nga një instruktor. Shkalla **numerike** është forma më e thjeshtë.

5 - **Shkëlqyeshëm**, përmbush të gjitha standardet.
 4 - **Shumë mirë**, përmbush shumicën e standardeve.
 3 - **Mirë**, përmbush disa standarde.
 2 - **Mjaftueshëm**, përmbush pak standarde.
 1 - **Dobët**, nuk përmbush asnjë standard.

Ekspertët thonë se shumica e shkallëzimeve për vlerësim duhet të përmbajnë vetëm pesë nivele të ndryshme të cilësisë. Nëse vendosen më shumë se pesë nivele, vështirësohet përdorimi i shkallëzimit.

Shkallëzimi grafik është, gjithashtu, i përhapur (shih figurën 1).

Për gjatë grafikut, vendoset një kuti për plotësim, për të treguar nivelin e përmbushjes.

Shkallëzimi më i ndërlikuar dhe më objektiv (i paanshëm) është **shkallëzimi grafik përshkrues** (shih figurën 2). Duke iu referuar shembullit tonë, “Përgatitja e pilafit”, kemi:

Ky lloj shkallëzimi, megjithëse kërkon mjaft kohë për t’u hartuar, u jep nxënësve një pasqyrë të qartë se çfarë pritet prej tyre. Me këtë shkallëzim, nxënësi mund të vlerësojë produktin e tij fare lehtë.

Te figura 2 ka një hapësirë për “Komente.” Aty, instruktori mund të shkruajë vërejtjet dhe sugjerimet e tij, të cilat mund ta ndihmojnë nxënësin të përmirësohet gjatë përmbushjes tjetër.

Nëse instruktori lejon toleranca, përdoret një **shkallëzim grafik përshkrues**.

Toleranca përkufizohet si: *shkalla, brenda së cilës nxënësi mund të shmanget nga standardi dhe akoma të qubet i suksesshëm.*

Nuk mund të pritet që një produkt të jetë i përsosur. Instruktori i mirë duhet të informojë nxënësin për tolerancat e lejuara. Këto toleranca

duhet të përputhen me ato të lejuara në botën e biznesit ose të industrisë. Figura 3 tregon një shembull, duke përdorur aftësinë e përzgjedhur nga ne, “Përgatitja e pilafit”. Përsëri, ky shkallëzim lejon shumë pak hapësira për keqkuptime.

7. Formatohet instrumenti i shkallëzuar. Instrumenti i shkallëzuar, normalisht përmban këto hapësira për informacion:

- Emri i nxënësit,
- Data e testit.

8. Jepen udhëzime të qarta për përdorimin e testit. Shembulli në vijim:

9. Përcaktohet niveli minimal i pranueshëm që kërkohet për përmbushjen. Çdo test, madje edhe testi i përmbushjes, ka një minimum të pranueshëm pikësh. Për një instrument të shkallëzuar, nëse çdo kriter shoqërohet me maksimumi 5 pikë,

Udhëzime: Shkallëzimi përmbushjes duhet përfshirë në listën e kriterit me të paktën të jetë 4 pikë për çdo kriter, vendoset një tekast shkallëzimi me 80% të kriterëve të testit, bëhet fjalë për një nivel minimal të përmbushjes

në **total** dhe jo për çdo kriter më vete. Kështu, për 10 kriteret niveli minimal i përmbushjes do të jetë 40 pikë. Për 8 kriteret, niveli minimal i përmbushjes do të jetë 32 pikë, e kështu me radhë. Por, ka raste që kërkohet të vendoset një nivel minimal përmbushjeje (zakonisht 2 pikë) për **çdo** kriter. Nëse nxënësi merr 1 pikë në ndonjë kriter, kërkohet që ai të praktikohet më shumë, që do të thotë se ai duhet të rivlerësohet gjatë një përpjekjeje tjetër, në mënyrë që të sigurojë nivelin minimal të pranueshëm për çdo kriter më vete. Ja një shembull:

Niveli minimal i pranueshëm i përmbushjes: Çdo kriter shoqërohet me 5 pikë maksimumi. Të gjitha kriteret duhet të marrin 2 pikë e sipër dhe pikët totale minimale janë 2 shumëzuar për numrin e kriterëve, me kusht që, për çdo kriter nxënësi të marrë të paktën 2 pikë.

Përfundim

Përmbushja përfshin si procesin, ashtu edhe produktin. Secili prej tyre është i ndryshëm. Ata duhet të vlerësohen me instrumentet e duhura. Për vlerësimin e produkteve, më i përshtatshëm është instrumenti i shkallëzuar i vlerësimit. Ky lloj testi kërkon kohë për t'u hartuar, por ai i jep mundësi nxënësit të vlerësojë përmbushjen e tij.

Literatura:

- John Collum: "Evaluate performance - Product", skill card.
- Rudolf Batliner: "Overview of Learner Assessment", skill card.
- *Teaching & Learning/ Assessment VET*, website.
- *Product Assessment*, website.

10. Rishikohet periodikisht instrumenti i shkallëzuar. Vëzhgohet përshtatshmëria e instrumentit. Nëse nxënësit kanë vazhdimisht vështirësi me pjesë të caktuara të instrumentit, së pari shqyrtohen metodat mësimore të përdorura, për t'u siguruar që po përdoren teknikat e duhura. Së fundi, shqyrtohen fjalët e përdorura për hartimin e kriterit dhe përshkrimet për çdo shkallëzim.

Niveli minimal i pranueshëm i përmbushjes: Çdo kriter shoqërohet me 5 pikë maksimumi. Të gjitha kriteret duhet të marrin 2 pikë e sipër dhe pikët totale minimale janë 2 shumëzuar për numrin e kriterëve, me kusht që, për çdo kriter nxënësi të marrë të paktën 2 pikë.

Figura 1. Shkallëzimi grafik

!-----!-----!-----!-----!
 Dobët Mirë Shkëlqyeshëm

Figura 2. Shkallëzimi grafik përshkrues

Kriteri: Materialet e huaja

1	2	3	4	5
!-----!-----!-----!-----!-----!				
Shije ranore në krejt masën.		Shije ranore vende-vende.		Shije jo ranore.
Copëza shumë të dukshme.		Disa copëza të dukshme.		Copëza jo të dukshme.

Komente:

Figura 3. Tolerancat

Kriteri: Temperatura e të shërbyerit (Celsius)

1	2	3	4	5
---	---	---	---	---

Vlerësimi i procedurës së punës së nxënësve në AFP

Mirela ANDONI
Instituti i Kurikulave
dhe i Trajnimit

Detyra, produkti dhe procedura e punës

“Kompetenca njerëzore është mundësia për të punuar. Dituria është vetëm një vlerë e vogël”. (William Blank). Produkti përfundimtar i shkollës është performanca e nxënësit. Në AFP kompetencat e nxënësit ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në përshtatjen e tij ndaj tregut të punës. Si rrjedhim, arritja e objektivave të parashikuar në kurikul (sidomos kur ata janë në përputhje me standardet e punës), merr rëndësi të veçantë. Në procesin mësimor realizohet ajo që është parashikuar në kurikul dhe në fund nxënësi vlerësohet si i ka përmbushur objektivat e parashikuar. Veçanërisht në lëndët praktike, merr një rëndësi të posaçme vlerësimi i performancës që përfshin njohuri, shprehi dhe qëndrime për të kryer një detyrë sipas një standardi, që shpie në prodhimin e një produkti. **Produkti është objekti i krijuar pas demonstrimit të një detyre ose shërbimi i kryer gjatë tij.**

Shembuj detyrash janë:

- riparo gomën e automobilit;
- gatuj pasta “flora”;
- përgatit faturën e klientit;
- mat tensionin e gjakut etj.

Në cilat raste mësuesi do të vlerësojë produktin dhe kur ai do të vlerësojë procedurën e punës?

Vlerësimi vetëm i produktit të punës kryhet:

- kur produkti i punës është më kritik se procedura;

- kur ekziston më shumë se një procedurë e pranueshme;
- kur procedura është vështirë të vëzhgohet (p.sh. zhvillimi i filmit në dhomën e errët).

Për shumë shprehje procedura e përdorur është më e rëndësishme se produkti përfundimtar. Kjo merr rëndësi të veçantë në ato raste kur nxënësi për herë të parë mëson një shprehje komplekse ose kryen një procedurë të rrezikshme.

Procedura është një seri hapash që kryhen sipas një radhe të duhur për përmbushjen e një detyre.

Një hap është një pjesë e vogël e përcaktuar e shprehisë.

Shembull: nëse shprehja është “*mat tensionin e gjakut*”, disa hapa do të jenë:

- Identifiko pacientin;
- Shpjegoi procedurën pacientit;
- Poziciono pacientin;
- Liro nga rrobat krahu e pacientit;
- Vendos aparatit matës të tensionit etj.

Procedurat e punës janë dy llojesh:

- a) *Procedura vijuese apo lineare*, kur hapat janë të dallueshëm dhe të përcaktuar qartë, në mënyrë që gjithmonë hapi i dytë ndjek të parin, i treti ndjek të dytën etj., p.sh. formatimi i disketës.
- b) *Procedura vendimi*, e cila përbëhet nga disa procedura vijuese, të cilat bashkohen në një pikë, sipas një ose më shumë vendimesh. Shembuj të këtyre procedurave janë ato që kanë të bëjnë me gjetjen e defekteve në makina, në të cilat për diagnostikimin e defektit përdoren dy a më shumë procedura vijuese.

Procedura e punës vlerësohet:

1. Kur duam të sigurohemi se nxënësit mund të përdorin mjetet dhe pajisjet në mënyrën e duhur.
2. Kur koha e demonstrimit të shprehisë është e rëndësishme.
3. Kur rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë janë të përfshira në procedurë;
4. Kur nxënësi punon me materiale të shtrenjta, të cilat mund të prishen nëse nuk zbatohet si duhet procedura.

Rëndësia e vëzhgimit në vlerësimin e nxënësit

1. Vëzhgimi i vazhdueshëm i nxënësit (dhe i shprehive të punës) gjatë punës mund të sjellë një kontroll të përparimit të tij. Mësuesi është në kohë të korrigojë probleme apo gabime që mund të vihen re.
2. Vlerësimi i nxënësit nëpërmjet vëzhgimit është më i përdorshëm, kur nuk mund të kryejmë test me shkrim.
3. Ky lloj vlerësimi nuk kërkon një kohë të përcaktuar, pra mund të realizohet kurdoherë në mënyrë formale dhe informale.
4. Për vlerësimin e një detyre apo sjelljeje të nxënësit, kjo lloj metode vlerësimi është më e përdorshme.

Gjatë vlerësimit të procedurës së punës ka rëndësi, gjithashtu, të përcaktohet *natyra e shprehisë* që vlerësohet, e cila mund të jetë:

- a) *Psikomotore (lëvizore)*. Procedurat janë të thjeshta, pasi nxënësi ndjek hapat në vijueshmëri (nga hapi i parë kalon tek i dyti,.....), mjafton që ai të kryejë procedurën sipas radhës së përcaktuar. Këto janë lehtësisht të vëzhgueshme dhe të vlerësueshme.
- b) *Konjitive (njohjeje)*. Procedurat ndonjëherë janë komplekse, me shumë pika ku duhet të merren vendime dhe nxënësit i duhet të zgjidhë situata problemore. Këto kanë vështirësi të vëzhgohen dhe vlerësohen.

Kërkesat për vlerësimin e procedurës së punës

Për vlerësimin e procedurës së punës kanë rëndësi disa elemente:

1. Specifikimi i detyrës për kryerjen e së cilës do të vlerësohet procedura e punës.
2. Përcaktimi i detyrës, nëse është psikomotore apo konjitive.
3. Instrumenti matës i përzgjedhur të përputhet me objektivin që do të vlerësohet.
4. Përzgjedhja sa më e drejtë e instrumenteve matëse.
5. Zhvillimi i instrumenteve të përzgjedhura; në rastin e procedurës së punës hartohet lista e hapave të demonstrimit të shprehisë.

6. Komunikimi i detyrës që do të vlerësohet te nxënësit.
7. Duhet punuar paraprakisht që nxënësit të jenë familjarizuar me instrumentin e vlerësimit.
8. Komunikimi i kushteve të vlerësimit (koha, vendi, pajisjet, mjetet e punës, kohëzgjatja etj.)
9. Për vlerësimin e një shprehje praktike duhet pasur kujdes që nxënësit të kenë zhvilluar praktikën e mjaftueshme gjatë procesit mësimor.

Etapat për vlerësimin e procedurës së punës

Në vlerësimin e procedurës së punës ka rëndësi përcaktimi korrekt i hapave për kryerjen e saj. Nëse është kryer analiza e detyrës, lista e hapave është në dispozicion dhe do të jetë e nevojshme të kryhet vetëm verifikimi i saj, duke u konsultuar me libra apo artikuj si dhe me ekspertë nga tregu i punës.

Hapat për vlerësimin e procedurës përfshijnë tri etapa: para, gjatë dhe pas vlerësimit.

Para vlerësimit të procedurës së punës:

1. Përcaktohet detyra, procedura e së cilës do të vlerësohet. Emri i detyrës duhet të jetë në krye të udhëzuesit të përmbushjes, i njëjtë me atë që është përdorur në mësim.
2. Përcaktohen hapat dhe vijueshmëria e tyre. Hapat shkruhen qartë dhe thjeshtë, me terma të njëjtë me ata të industrisë. Vendosen në çdo hap termat e performancës që vëzhgohet. Hapat nuk duhet të mbulojnë njohuri teorike. Çdo hap duhet të fillojë me folje vepruese dhe të kompletojë fjalinë: “ A e kreu nxënësi.....”
3. Shënohen hapat kritikë. Në udhëzues tregohet në cilin hap do të ndërpritet demonstrimi nëse nxënësi nuk e kryen mirë.
4. Përgatitet një listë hapash të mjaftueshëm për vlerësimin e procedurës (jo shumë të shkurtër, si, p.sh., 3-4 hapa, por as shumë të gjatë, si, p.sh., mbi një faqe).
5. Bashkëngjitet shpjegimi për mënyrën e vlerësimit. Kjo mund të jetë e përcaktuar si listë kontrolli Po, Jo, ose me shkallëzim vlerësimi nga 1-5.

6. Përgatitet dhe kontrollohet udhëzuesi i zbatimit, i cili përmban emrin e nxënësit dhe datën.
7. Paraqiten qartë udhëzimet për përdorimin e udhëzuesit të zbatimit.
8. Vendoset niveli minimal i pranueshëm për performancën e kërkuar nga nxënësi.
9. Rishikohet udhëzuesi i përmbushjes në mënyrë periodike. Nëse janë paraqitur vazhdimisht probleme, duhet të rishikohen metodat e mësimdhënies, mënyra e demonstrimit si dhe mënyra se si janë shkruar hapat.

Gjatë vlerësimit të procedurës së punës:

1. Kontrollohet nëse nxënësit kanë bërë gati të gjitha mjetet për vlerësim.
2. Kontrollohet nëse nxënësi ndjek të gjitha hapat në vazhdimësi.
3. Kontrollohet nëse nxënësi është i kujdesshëm në hapat kritikë.
4. Kontrollohet nëse nxënësi përmbush të gjithë hapat sipas udhëzuesit të përmbushjes.
5. Kontrollohet e gjithë përmbushja e detyrës nga nxënësi.

Pas vlerësimit të procedurës së punës:

1. Informohet nxënësi për rezultatet e vlerësimit.
2. Jepet një fdbek nëse ka.
3. Përsëriten pjesëmarrësit në vlerësim.

Udhëzuesi i përmbushjes i jepet nxënësit gjatë procesit mësimor, para kryerjes së demonstrimit nga instruktori. Ai e përdor atë gjatë të praktikuarit dhe në fund ajo përdoret për vlerësim.

Një nga detyrat e instruktorit është të ndjekë nxënësit nëse përdorin saktë procedurën; për këtë është mirë të përdoret lista e kontrollit.

Literatura:

- Materiale të TTTI-t (Training Institute for Technical Instruction) për trajnimin e trajnerëve.

Njehsimi i rezultateve të vlerësimit të nxënësve

Mirela ANDONI
**Instituti i Kurikulave
dhe i Trajnimit**

Në arsim, një notë apo shprehje nënkupton një vlerësim (gjykim) standard që kryen mësuesi për një punë ose veprimtari të caktuar të nxënësve. Vende të ndryshme e paraqesin në mënyra të ndryshme vlerësimin e nxënësve si, p.sh., me notë, me përqindje, me shprehje, me pikë, me shkallë etj.

Procesi i vlerësimit ka shumë aspekte që duhet të merren parasysh, por dy janë ato të cilat nxënësi i ndjen në mënyrë të drejtpërdrejtë: ndërtimi i instrumentit të vlerësimit me përcaktimin saktë të përgjigjeve dhe mënyra e vlerësimit të këtyre përgjigjeve. Njehsimi në fakt nuk ka ndonjë vlerë të qenësishme; ai është thjesht një shprehje e vlerësimit të marrë nga nxënësi, i cili mund të jetë me notë, me përqindje, me shkallë, me shprehje etj.

Çdo sistem arsimor në vende të ndryshme ka skemën e vet të njehsimit, si dhe standardin e shprehjes së vlerësimit, që mund të jetë i ndryshëm. Po paraqesim disa nga këto mënyra:

- Njehsimi me 20 pikë shkallëzimi.

Shkallët	Vlerësimi
20	I përsosur
19 18	Gati i përsosur
17	I spikatur/ I shquar
16	Shkëlqyeshëm
15 14	Mirë
13 12	Kalueshëm
11 10	Mjaftueshëm
9	Ngelës

- Sistemi evropian i transferimit të krediteve është një sistem që mundëson lëvizshmërinë e krediteve nga njëri vend në tjetrin. Ky sistem përmban, gjithashtu, një njehsim të shkallëzuar për vlerësimin.

Shkallët	Vlerësimi
A	90-100
B	65-90
C	35-65
D	10-35
E	0-10

- Në shkollat evropiane ka, gjithashtu, një formë tjetër njehsimi, si më poshtë:

Shkallët	Vlerësimi
10	Shkallë e lartë e arritjes
8.5	Shumë mirë
7.5	Mirë
6	Mjaftueshëm
< 6	Kalueshëm
0	Ngelës

Për njehsimin sa më objektiv të rezultateve të vlerësimit duhen marrë parasysh disa elemente:

- Analiza e objektivave të kurikulës;
- Përgatitja e tabelës së specifikimit;
- Përzgjedhja e instrumentit të vlerësimit;
- Përcaktimi i çështjeve në instrumentin e përzgjedhur të vlerësimit;
- Komunikimi me nxënësit/kursantët;
- Analiza e rezultateve të vlerësimit;
- Njehsimi i rezultateve të vlerësimit.

Në sistemin shqiptar të vlerësimit për vlerësimin e nxënësve përdoren notat dhe, për rastet e kurikulës modulare, për praktikatat përdoren edhe shprehjet. Njehsimi i rezultateve merr në vëmendje këto elemente:

- numrin maksimal të pikëve, që d.m.th nëse nxënësi merr maksimumin e pikëve merr notën 10;

- shkallën e rëndësisë së pikëve të marra, pra nëse për objektivin që ka shumë rëndësi nuk ka marrë asnjë pikë, merr notën 4 ose, nëse është modul (instrumenti i vlerësimit është lista e kontrollit), nuk e kalon modulin;
- sipas shkallëzimit të rëndësisë së objektivave dhe shpërndarjes së pikëve që merr nxënësi, përcaktohet edhe shkallëzimi për njehsimin e rezultateve të vlerësimit.

Pra, në njehsimin e rezultatit të vlerësimit ka rëndësi jo vetëm numri i pikëve të marra, por dhe shpërndarja e tyre sipas rëndësisë së objektivit që do të vlerësohet.

Literatura:

- Andoni Mirela: *Parimet dhe prirjet e vlerësimit të nxënësve në arsimin dhe formimin profesional*, Buletini “Arsimi dhe Formimi Profesional”, 9. 2006.
- Mager Robert F.: *Measuring Instructional Results*, 1997, SHIBA.

Projekte në arsimin profesional e teknik

Ruzhdi REÇI
Ministria e Arsimit
dhe e Shkencës

Fondi i Inovacionit, i financuar nga BE-ja, ka për qëllim të mbështesë zhvillimin e arsimit dhe të formimit profesional, mbi bazën e konkurrimit të projekteve të përbashkëta të shkollave profesionale e teknike dhe të qendrave të formimit profesional me organizata jo fitimprurëse. Më poshtë po trajtojmë aktivitetet dhe rezultatet e tri projekteve fituese të vitit shkollor 2007-2008 në fushën e arsimit profesional e teknik.

I. Trajnim dhe mbështetje me libra e materiale mësimore e mësuesve specialistë të shkollave teknike ekonomike dhe të hoteleri - turizmit

Fondacioni “Arsimimi i të Rriturve në Shqipëri, PARSh” në bashkëpunim me shkollën teknike ekonomike të Tiranës dhe Sektorin e Arsimit Profesional dhe të të Rriturve në MASH, në kuadër te projektit Xpert-PBS-1, të financuar nga Fondi i Inovacionit të Komisionit Evropian, organizoi gjatë muajve shtator 2007- prill 2008 në ndihmë të shkollave teknike këto aktivitete:

- 1. Trajnimi i 5 drejtuesve dhe i 25 mësuesve specialistë nga shkollat teknike:** “Ekonomike” dhe “Hotelieri-Turizëm “Tiranë, “Teknologjike” Shkodër, “Kolin Gjoka” Lezhë, “Isuf Gjata”, Korçë, “Tregtare” Vlorë dhe të shkollave të mesme të përgjithshme : “ Sami Frashëri”, “ Ismail Qemali”, “ Qemal Stafa”, “ Besnik Sykja” dhe “Petro Nini” Tiranë, me një cikël modulesh të programit **XPERT Personal Business Skills (XPBS)**.

Këto module janë hartuar nga grupe ekspertësh evropianë për përhapjen dhe përmirësimin e kompetencave sociale të domosdoshme për standardet e sotme në Evropë, të përgatitura nga Qendra Evropiane e Testimeve Master (QETM) në Dortmund të Gjermanisë dhe janë

përshtatur në gjuhën shqipe nga specialistët e Fondacionit PARSh, që gëzon ekskluzivitetin në Shqipëri.

Në tetë seminare të trajnimit 20-orëshe u zhvilluan 12 module të ndara në 4 fusha kryesore kompetencash:

- a) Si të flasim dhe të negociojmë (3 module)
- b) Si të planifikojmë dhe të organizojmë efektivisht (4 module)
- c) Si të moderojmë proceset në grup (3 module)
- d) Si të bëjmë prezantime për një qëllim të caktuar (2 module).

2. Përkthimi nga gjermanishtja, përshtatja dhe botimi i moduleve të mëposhtme:

- “Organizimi dhe zbatimi i suksesshëm i projekteve “
- “ Të referojmë në mënyrë efikase”
- “Të negociojmë, të diskutojmë dhe të argumentojmë “
- “Zgjidhja e konflikteve në grupe”

3. Përgatitja e materialeve mësimore për modulet:

- “ Biseda të sukseshme në shitje”
- “ Vendime kompetente, veprime me përgjegjësi”
- “ Të zgjidhësh probleme, të zhvillosh ide”
- “Material mësimor për 4 modulet e mësipërme”

4. Seminari i tetë i trajnimit (10-12.04.2008) u zhvillua nga 2 multiplikatore të reja, të zgjedhura nga pjesëmarrëset e shtatë seminareve të mëparshme dhe 15 mësues të rinj specialistë të shkollave të Tiranës (nga shkollat teknike: Ekonomike; Hoteleri -Turizëm, Ndërtim dhe nga pesë gjimnaze).

5. Trajnimi u shoqërua nga testimi pas çdo seminari i pjesëmarrësve, shumica e të cilëve, në bazë të rezultateve të arritura, fituan **Certifikatën Evropiane XPERT- PBS** për të gjitha modulet e përfshira në trajnim dhe 15 prej tyre u certifikuan në një nivel më të

lartë, me **Certifikatën Evropiane XPERT-Personal Business Skills PRO**.

Këto certifikata, që njihen në vendet e BE-së, u japin të drejtën drejtuesve dhe mësuesve tanë specialistë të ndjehen të barabartë me homologët e tyre evropianë dhe të kenë të drejtën për përdorimin e njohurive të këtyre moduleve dhe për pasurimin e kurikulës së shkollave teknike ekonomike të hoteleri-turizmit. Gjithashtu, ata kanë të drejtë, në rolin e multiplikatorëve, të trajnojnë kolegët e tjerë të shkollës së tyre ose të shkollave të tjera.

6. Shpërndarja e librave dhe e materialeve mësimore përkatëse.

Të gjithë pjesëmarrësit e seminareve të trajnimit u pajisën me materiale mësimore të fotokopjuara dhe me CD si dhe me katër libra të shtypur sipas moduleve të trajtuara më sipër. Gjithashtu, bibliotekat e pesë shkollave teknike ekonomike dhe të shkollës së hoteleri- turizmit të Tiranës, që morën pjesë në këto seminare trajnimi, do të pajisen me:

- **10 CD-ROM** dhe fotokopje për çdo titull të **materialeve mësimore të përgatitura**.
- **200 copë libra** (nga 50 copë libra për çdo modul të përkthyer nga gjermanishtja).

Ky fond krijon një bazë të mirë materialesh mësimore, librash dhe një grup multiplikatorësh të trajnuar, që janë pasuri e shkollave publike teknike ekonomike dhe të hoteleri-turizmit, e cila do të përdoret më vonë nga këto shkolla për të trajnuar qoftë mësues të tjerë, ashtu dhe nxënës, brenda kurikulës mësimore ose jashtë saj.

Trajnimet e realizuara në kuadër të këtij projekti do të ndikojnë në përmirësimin e cilësisë në drejtim, në organizimin dhe menazhimin e punëve në shkollat teknike e profesionale dhe në mësimdhënie, sidomos në praktikën mësimore. Ato do të ndikojnë edhe në përfitim të një edukate evropiane pune, në vlerësimin e gjërave nga këndvështrimi ekonomik, në rritjen e cilësisë së vendimmarrjes dhe të kreativitetit në shkollat pjesëmarrëse në këtë aktivitet.

Modulet e trajtuara gjatë trajnimit janë ndërtuar në atë mënyrë që mund të punohen në mënyrë autodidakte nga çdo mësues dhe nxënës. Kjo bën të mundur që këto module dhe materialet mësimore të përdoren jo vetëm për mësuesit e trajnuar, por edhe nga drejtues, mësues dhe nxënës të shkollave të tjera ekonomike.

Nga pyetësorët e plotësuar mbas përfundimit të trajnimit nga drejtuesit dhe mësuesit specialistë që morën pjesë në këto seminare, del se cilësia e trajnimeve dhe e materialeve mësimore ka qenë e lartë dhe se mësueset e trajnuara tregojnë interes për vazhdimin në të ardhmen të projekteve me module të reja, të cilat ndikojnë jo vetëm në rritjen e kualifikimit të tyre, por edhe në cilësinë e dhënies së mësimin të nxënësit.

II. Ngritja e Sistemit të menazhimit të informacionit në shkollën profesionale “Beqir Çela” në Durrës

Në shkollën profesionale kombëtare “Beqir Çela” në Durrës, është ngritur “Sistemi i menazhimit të informacionit të shkollës (SMIS)”, i financuar nga Fondi i Inovacionit të BE-së, në kuadër të projektit CARDS 2004.

SMIS-i, i pari i këtij lloji që ngrihet në shkollat shqiptare, u realizua nga projekti i përbashkët i Drejtorisë së shkollës dhe i Institutit Shqiptar për Studime dhe Edukim në Teknologjinë e Informacionit “ISSETI” (me vlerë rreth 40.000 euro).

Në ceremoninë e përirimit morën pjesë: këshilltari i Kryeministrit për Arsimin z. Myqerem Tafaj, zv/Ministrja e Arsimit dhe e Shkencës znj. Adriana Kumbaro, Drejtori i Përgjithshëm i Zgjerimit pranë Komisionit Evropian në Bruksel, z. Dirl Lange, Prefekti, Kryetari i Qarkut dhe deputetë të Durrësit.

Në fjalën e mirëseardhjes drejtori i shkollës z. Bashkim Shkëmbi bëri një paraqitje të shkurtër të aktivitetit të shkollës dhe të ndikimit pozitiv që do të ketë vënia në punë e projektit “Sistemi i menazhimit të informacionit në shkollë”.

Të ftuarit në fjalën e tyre vlerësuan punën e mirë që është bërë nga drejtorja e shkollës, stafi pedagogjik dhe nxënësit e shkollës për përgatitjen cilësore të nxënësve sipas kërkesave të biznesit dhe të teknologjisë së re.

Zonja A. Kumbaro dhe zoti Dirl Lange prejnë shiritin e përirimit të projektit dhe ftuan pjesëmarrësit në këtë aktivitet për të parë mjedisin, pajisjet dhe funksionimin e Sistemit të menazhimit të informacionit të shkollës “Beqir Çela”

Sistemi i menazhimit të informacionit në shkollën profesionale “Beqir Çela” në Durrës përbëhet nga një rrjet prej 30 kompjuterësh, të

cilët janë vendosur sipas skemës: 18 kompjuterë në mjediset e shkollës dhe 12 kompjuterë në repartet e praktikave profesionale e në magazinë.

Ky projekt u shoqërua nga një trajnim disa ditor i mësuesve të teorisë e të praktikës profesionale dhe të punonjësve të administratës së shkollës, nga specialistët e ISSETI-it, në lidhje me përdorimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menazhimit të informacionit të shkollës.

Sipas drejtorit të shkollës, që ka qenë nismëtar i këtij projekti, “stafi drejtues i shkollës, krahas përcaktimit të synimit, objektivave dhe të drejtimeve kryesore të punës për realizimin e procesit mësimor-edukativ, gjatë këtij viti mësimor u fokusua dhe në rritjen e rolit të menazhimit të shkollës, për të ndikuar në rritjen e të gjithë treguesve mësimorë-edukativë, si dhe të atyre administrativo-financiarë. Çdo anëtar i stafit drejtues i kërkohet ndjekja në mënyrë të vazhdueshme e cilësisë së zhvillimit të procesit mësimor, që nënkupton përgatitjen ditore të mësuesve, vlerësimin ritmik dhe frekuentimin nga ana e nxënësve. Kështu, mbështetur në këtë objektiv, u përcaktua se çfarë kërkohet nga sistemi i menazhimit të informacionit në shkollë.

Menazhimi i informacionit konsiston në instalimin e një rrjeti kompjuterik, ku janë të lidhura të gjitha hallkat përkatëse të infrastrukturës mësimore dhe të asaj administrative. U pajisën të gjitha kabinetet mësimore dhe zyrat administrative me një rrjet kompjuterësh, ku është instaluar një program i ngjashëm me regjistrin e klasës. Mësuesit, paralel me punën në regjistër, pasqyrojnë frekuentimin dhe vlerësimin e çdo ore mësimi dhe të gjitha të dhënat e nevojshme të nxënësve, po kështu ai pasqyron dhe përgatitjen e tij ditore. Ky informacion merret në një kohë shumë të shpejtë nga stafi drejtues, i cili bën vlerësimet e situatës dhe përcakton veprimet e mëpasshme. Ndërkohë, ekzistenca e lidhjes në rrjet krijon mundësinë që në fund të vitit rezultatet që nxjerr çdo mësues t'i transmetohen direkt sekretarisë së shkollës, sipas një formati të ngjashëm me amzat, duke regjistruar në një kohë shumë të shpejtë dhe pa gabime rezultatet e nxënësve.

Nga ana e menazhimit administrativ dhe financiar informatizimi konsiston përkatësisht në këto vlera:

Menazhimi i informacionit administrativ, i cili përfshin regjistrimin e nxënësve me të dhënat e tyre (gjeneralitetet) në sekretarinë e shkollës dhe pasqyrimin e rezultateve të tyre, të cilat janë transparente dhe të lexueshme në çdo moment të kohës nga ana e stafit.

Menazhimi i informacionit financiar, i cili konsiston në lidhjen në rrjet, sipas një programi përkatës të financës me magazinat, ku janë të pasqyruara në mënyrë transparente të gjitha operacionet financiare, që edhe këto janë të lexueshme në çdo kohë nga ana e stafit dhe e të interesuarve të tjerë.

Ky menazhim informacioni krijon dhe një mundësi me tepër tani dhe për të ardhmen, sepse pasja e një faqeje në internet krijon mundësi për komunikimin me prindërit, për të parë rezultatet dhe frekuentimin e fëmijëve të tyre në shkollë, në një kohë shumë të shpejtë. Gjithashtu, afishimi i programeve dhe i të dhënave për nxënësit krijon një komunikim të shpejtë me biznesin dhe rrit interesin e tij.

Si përfundim, duhet të vëmë në dukje disa gjëra të rëndësishme:

- Ky informatizim e lehtëson punën e mësuesve, pasi shumë pasqyra që kërkohen nuk do të jetë e nevojshme t'i plotësojnë. Themelore është që stafi drejtues merr një informacion të shpejtë dhe të vazhdueshëm, duke bërë të mundur marrjen e masave për çdo problem.
- Ky informatizim nuk do të thotë që stafi drejtues nuk do të bëjë monitorimet e drejtpërdrejta të mësuesit, por me këtë informatizim monitorimi do të fokusohet kryesisht në metodat e mësimdhënies dhe aty ku vihen re dobësi.
- Prania e kompjuterëve në çdo kabinet ka krijuar mundësinë që me ndihmën e aparateve të tjera të realizohen mësimet interaktive.”

Rasti i vendosjes së sistemit të menazhimit në shkollën profesionale “Beqir Çela” tregon se drejtuesit e shkollave profesionale kanë përgatitje të mirë në hartimin e projekteve të ndryshme në shërbim të shkollës dhe, të mbështetur nga organizata jofitim prurëse si ISSETI, kanë mundësi të fitojnë në konkurrimet që do të organizohen për grantet e fondeve të Inovacionit, të financuara nga Bashkimi Evropian.

III. Në ndihmë të zhvillimit cilësor të lëndës së informatikës në shkollat teknike e profesionale

Fondacioni PARSH (arsimimi i të rriturve në Shqipëri), në bashkëpunim me sektorin e arsimit profesional dhe të të rriturve në MASH, në kuadër të projektit Xpert-ECP-1 të Fondit të Inovacionit të Komisionit

Evropian, organizoi gjatë muajve nëntor 2007- prill 2008 këto aktivitete për shkollat teknike dhe profesionale:

1. Trajnimi i 30 mësuesve të informatikës të 20 shkollave teknike e profesionale: “Stiliano Bandilli” dhe “Kristo Isak” në Berat, “Ali Myftiu” dhe “Sali Çeka” në Elbasan, “Mihal Shahini” në Cërrik, “Demir Progni” dhe “Isuf Gjata” në Korçë, “Agro-Turizëm” në Golem, “Tregtare” në Vlorë, “ Teknologjike” dhe “Arben Broci” në Shkodër, “Kolin Gjoka” në Lezhë, “Hoteleri-Turizëm”, “Karl Gega”, “Gjergj Canco” dhe “Ekonomike” në Tiranë, “Rakip Kryeziu” në Fier, “Agro-Biznes” në Kamëz, “Hysen Çela” dhe “Beqir Çela” në Durrës.

- Në dy trajnimet e para treditore morën pjesë 15 mësues të lëndës së informatikës për çdo trajnim. Pjesëmarrësit, gjithsej 30 mësues, u trajnuan në lidhje me materialet mësimore të produkteve të MS office, pjesë e sistemit Xpert-European Computer Passport dhe metodikat e përdorimit të tyre.

Në seminar materialet mësimore u paraqitën në Power Point për modulet e mëposhtme:

- Bazat e PED me Windows XP,
- Bazat e përpunimit të tekstit me MS Word, kalkulimi tabelor me MS Excel,
- Bazat e Internetit me Internet Explorer,
- Bazat e të dhënave me MS Access,
- Prezantimet me MS Power Point
- Komunikimi me MS Outlook.

Këto materiale mësimore mbulojnë plotësisht kurikulën mësimore për informatikën në shkollat teknike dhe profesionale në modulet përkatëse.

Në testimin përfundimtar mësuesit pjesëmarrës në trajnim, në bazë rezultateve të arritura, fituan **Certifikatën evropiane Xpert-ECP**, e cila është e vlefshme në të gjitha vendet e BE-së.

- Në dy trajnimet e dyta treditore morën pjesë 15 mësues informatike për çdo trajnim. Këto trajnime synonin që pjesëmarrësit të përvetësonin elementet e thjeshta të mirëmbajtjes së sistemeve kompjuterike me Windows XP dhe njohuri teoriko-praktike për rrjetet e kompjuterëve.

2. **Përgatitja e materialeve mësimore dhe e librave mbështetës për kurikulën e informatikës të shkollave profesionale e teknike**, bazuar në materialet mësimore moderne të moduleve të sistemit Xpert-Certifikata Evropiane për kompjuter.

- Përkthimi nga gjermanishtja dhe publikimi i dy librave (me rreth 200 faqe secili) të moduleve të serisë PC System Support:

Teknologjitë e rrjeteve dhe të Internetit

Mirëmbajtja e sistemeve me Windows X P professional

Çdo mësues i informatikës që mori pjesë në këto seminare trajnimi u pajis nga projekti me të gjitha materialet mësimore, të shtypura dhe në CD, si dhe me dy librat e mësipërm.

3. **Shpërndarja e materialeve mësimore dhe e librave të moduleve të serisë PC System Suport:**

- Secila nga 35 shkollat teknike e profesionale të vendit është pajisur me nga **10 CD-ROM me materiale mësimore**, me **20 copë libra** për modulën **teknologjitë e rrjeteve dhe të Internetit** dhe **20 copë libra** për modulën **Mirëmbajtja e sistemeve kompjuterike me Windows XP Professional**.
- Këta libra do t'u shtohen 3000 copë librave të serisë Xpert-ECP, me të cilat PARSh-i pajisi bibliotekat e shkollave profesionale gjatë vitit 2007.

Mendimi i mësuesve që morën pjesë në këto seminare trajnimi është se këta libra mund të përdoren si tekste alternative për programet e informatikës së arsimit 9-vjeçar dhe të arsimit të mesëm të përgjithshëm e profesional, si më poshtë:

- Për bazat e kompjuterit (Hardware, Software, Sistemi operativ) mund të përdoret libri **Bazat e përpunimit elektronik të të dhënave me Windows XP**.
- Për aplikimet kryesore (funksionet kryesore të programeve, funksionet e Word Processing, funksionet e Spreadsheet, funksionet e aplikimeve për prezantime) mund të përdoren librat: **Bazat e përpunimit të tekstit me MS Word, Kalkulimi tabelor me MS Excel dhe Prezantimet me MS Power Point**.
- Për funksionet e bazave të të dhënave mund të përdoret libri **Bazat e të dhënave me MS Access**.

- Për aplikimet online (Interneti, posta elektronike) mund të përdoret libri **Bazat e Internetit me Internet Explorer**.
- Për rrjetet dhe internetin mund të përdoret libri **Bazat e Internetit me Internet Explorer** (ku përfshihen dhe njohuri të thjeshta për rrjetet).
- Për efektin e kompjuterit dhe të internetit në shoqëri mund të përdoret libri **Bazat e Internetit me Internet Explorer**.
- Nga pyetësorët e plotësuar mbas përfundimit të trajnimit nga mësuesit që morën pjesë në këto seminare, del se: cilësia e trajnimeve dhe e materialeve mësimore ka qenë e lartë dhe se mësuesit e lëndës së informatikës kanë nevojë për trajnime të reja në fushën e arkitekturës së kompjuterëve dhe të mirëmbajtjeve të thjeshta të hardwareve të kompjuterëve.

Trajnimet dhe aktivitetet e tjera të organizuara me kompetencë dhe seriozitet nga Fondacioni Arsimimi i të Rriturve në Shqipëri (PARSh), në kuadër të projektit ECP-1, financuar nga fondi i inovacionit të BE-së, kishin një vlerë të madhe, si nga ana metodike, ashtu edhe nga ajo shkencore, për mësuesit që japin lëndën e informatikës në shkollat teknike e profesionale.

Ne shpresojmë se kjo përvojë e fituar do t'u transmetohet nxënësve, të cilët, gjithashtu, në bibliotekat e shkollave të tyre do të gjejnë më shumë tekste dhe materiale mësimore të fushës së informatikës.